

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6020
E hënë, 9 mars 2020
çmimi 0.40 €

Vetëm 13.7 për qind e grave janë të punësuar në tregun e punës në Kosovë I FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

ISH-KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ KA PROPOZUAR TË DIELËN KONFERENCË DYDITORE PËR DIALOGUN KOSOVË - SERBI I FAQE 4-5

PRESIDENTI DHE QEVERIA KUNDËRSHTOJNË HARADINAJN PËR KONFERENCËN RRETH DIALOGUT



Presidenti i vendit, Hashim Thaçi, dhe qeveria e kanë kundërshtuar propozimin e liderit të AAK-së, Ramush Haradinaj, për të mbajtur një konferencë dyditore në Kosovë për pajtim rreth dialogut final me Serbinë. Ish-kryeministri Haradinaj ka thënë se tashmë në Kosovë ekzistojnë dy blloqe politike për dialogun që, sipas tij, kanë qasje ta gabueshme. Presidenti Hashim Thaçi ka thënë se ka interes të madh nga njerëz të caktuar ta prishin procesin e arritjes së marrëveshjes me Serbinë. Kurse zëvendëskryeministri Avdullah Hoti ka vlerësuar se Kosova ka institucionet e veta dhe nuk ka nevojë për konferenca rreth dialogut

Bashkurti: Dialogu me Serbinë, sfida e Albin Kurtit



Reka sqarohet për idenë e tij që Serbia të kalojë transit përmes Kosovës në detin Adriatik

Partitë opozitare, PDK-ja, AAK-ja dhe Nisma Socialdemokrate, kanë dalë kundër idesë së ministrit të Integrimit Evropian, Blerim Reka, që në këmbim të ulës së Kosovës në OKB, Kosova t'i lejojë Serbisë kalimin transit nëpër autostradë për në detin Adriatik. Reka përmes një reagimi për media ka theksuar se ky nuk është qëndrim i qeverisë, por një mendim i tij personal, duke bërë të qartë se mbrojnë qëndrimin e kryeministrit Kurti për reciprocitet me Serbinë I FAQE 3



OPINION

TË JESH GRUA

F. 11

Vlora
ÇITAKU



KUJTESË HISTORIKE: SI I NJOHA SHABAN, HAMËZ E ADEM JASHARIN? F. 11

Prof. Agim
ZOGAJ



AKTUALE

LUET JANË
TË BUKURA.
POR NE DUAM:



FILLON FUSHATA PËR BARAZI GJINORE F. 6

EKONOMI

ANULOHEN FLUTURIMET NGA ITALIA VERIORE DREJT PRISHTINË F. 9

PROGRAMI I QEVERISË, PA STRATEGJI AFATGJATË F. 9

SPORT

DRITA FITON DERBIN KUNDËR PRISHTINËS, GJILANI BIE NË 'ZAHIR PAJAZITI' F. 20



RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepgisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjiibiznesi.com
info@kolegjiibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Shqipëria, masa shtesë për parandalimin e koronavirusit

Pas apelit të presidentit të Republikës, Ilir Meta, Qeveria shqiptare do të mbledhet sot (e hënë) në një takim të jashtëzakonshëm për masat kundër koronavirusit, edhe pse në Shqipëri ende nuk ka rast zyrtar me këtë virus

TIRANË, 8 MARS - Edhe pse në Shqipëri ende nuk ka rast zyrtar me koronavirus, Ministria e Shëndetësisë ka marrë masa për të parandaluar çdo lloj situatë të mundshme. Bëhet me dije se pritet që për këtë situatë të mbledhet Komiteti teknik i ekspertëve të Ministrisë të Shëndetësisë.

Ndërkaq, pas apelit të presidentit të Republikës, Ilir Meta, qeveria do të mbledhet sot (e hënë) në një takim të jashtëzakonshëm për masat kundër koronavirusit. Takimi i cili pritet të zhvillohet rreth orës 9:00, pritet të ketë në fokus masat e marra dhe raportimin e ministrave përgjegjës para kryeministrit. Presidenti Meta në mesazhin e

thekson se “kam ndjekur me shqetësim të madh zhvillimet lidhur me pandeminë e koronavirusit, që për fat të keq janë rënduar së tepërmi, kur të gjithë do të donim që të ndodhte e kundërta. Në 31 janar të këtij vitit kam tërhequr publikisht vëmendjen për marrjen e masave sanitaro-epidemiologjike shumë të forta nga vendi ynë, edhe pse atëherë Italia kishte vetëm 2 të prekur nga koronavirusi”.

Këshilli i Ministrave të Italisë mori masa më drastike për koronavirusin. Kryeministri i Italisë, Giuseppe Conte firmosi gjatë natës mes së shtunës dhe së dielës, një dekret që detyron menjëherë masa të reja



shtrënguese për lëvizjen e njerëzve.

Ndërkohë operatorët ajrorë që kryejnë fluturime nga Tirana drejt Milanos kanë filluar të dielën t'i anulojnë fluturimet e tyre drejt Italisë. Kjo lëvizje vjen, pasi Qeveria italiane vendosi shpalljen e Lombardisë si zonë karantine, duke ndaluar lëvizjen deri në datën 3 prill.

Sipas faqes zyrtare të aeroportit të Rinasit, të paktën tri fluturime janë anuluar.

I pari është fluturimi drejt Romës i planifikuar në 5.30 të mëngjesit nga Air Albania. Po ky operator ka anuluar dhe fluturimin që është parashikuar për në Milano në orën 11.15, si dhe atë për në Bolonjë në orën 18.20.

të dielën ishin parashikuar të paktën 5 fluturime nga Tirana në Milano (Bergamo) nga Air Albania, Blue Panorama dhe Easy jet. Blue Panorama po kryen check-in për në Bergamo,

të parashikuar në 11.15. Alitalia po kryen fluturimet drejt Romës. Kështu, deri më 3 prill, për shkak të emergjencës nga koronavirusi, në Lombardi dhe në disa provinca: Veneto, Emilia Romagna e Piemonte është ndaluar hyrja dhe dalja e njerëzve. Hyrja apo dalja nga këto zona janë të lejuara vetëm për arsye serioze dhe “të provuara”, për punë ose familje. Ata që janë në karantinë nuk mund të lëvizin në asnjë mënyrë. Provincat në fjalë, tha kryeministri, janë: Parma, Piacenza, Rimini, Reggio-Emilia, Modena, Pesaro dhe Urbino, Venecia, Padova, Treviso, Alessandria, Verbano-Cusio-OSSOLA, Novara, Vercelli dhe Asti. Në total, këto masa do të prekin mbi një të katërtën e popullsisë italiane. Rajonet në fjalë janë të banuara nga rreth 15 milion banorë.

Numri i rasteve në Itali u rrit me

1,247 në 24 orët e fundit, tha agjencia e mbrojtjes civile në Itali. Kjo e rrit numrin e të prekurve në 5,883 raste. 36 persona të tjerë vdiqën në rajon, duke e çuar në total numrin e të vdekurve 233. Dekreti thotë ndër të tjera se duhet të “shmangni absolutisht çdo lëvizje brenda territoreve, përveç lëvizjeve të motivuara nga nevoja të punës ose situata emergjente”. Ata që kanë “simptoma të infeksionit të frymëmarrjes dhe temperaturë më të madhe se 37.5 ° C”, këshillohen të qëndrojnë në shtëpi dhe të kontaktojnë mjekun e tyre, duke kufizuar menjëherë të gjitha kontaktet sociale. Pushimi i zakonshëm i personelit shëndetësor dhe teknik, si dhe i “stafit, veprimtaritë e të cilit janë të domosdoshme për të menaxhuar aktivitetet e kërkuara nga njësitë e krizës të ngritura në nivelin rajonal” pezullohen.



Zbulohen bazat e kampingjeve në Shqipëri për të pritur refugjatët sirianë

TIRANË, 8 MARS - Gjirokastra, Kapshticë dhe Aerodromi i Gjadrit në Lezhë janë tre prej destinacioneve të mundshme për t'i pritur refugjatët sirianë që po përballen me një tmerr përgjatë kufirit turko-grek. Shqipëria në kuadër të respektimit të konventave të drejtave të njeriut dhe udhëzimeve që janë dhënë nga Bashkimi Evropian ka bërë gati bazat e strehimit në rast të ndonjë sulmi të paprecedentë. Janë 50 refugjatë sirianë që kanë mbërritur të shtunën gjatë natës në qytetin e Gjirokastrës. Refugjatët që kanë arritur deri tani, kryesisht janë nga Siria ndërsa u përkasin grup-moshave të ndryshme duke

qenë se janë shpërngulur nga vendet e tyre familjarisht. Ata kanë hyrë nga Greqia, shtet ky që po përballlet me një fluks tepër të madh refugjatësh që pas hapjes së kufirit nga ana e Turqisë. Kjo ka bërë që edhe autoritete shqiptare të marrin masa dhe të planifikojnë qendrat e pritjes, duke qenë se janë një portë hyrëse për në vendet e Bashkimit Evropian. Aktualisht refugjatët që kanë mbërritur në Gjirokastër po strehohen në Qendrën e pritjes në Gerhot, rreth 2 kilometra në veri të Gjirokastrës.

Pas krizës në Evropë me refugjatët nga Siria, burime të sigurta për Top Channel bëjnë me dije

se katër institucione në vend po diskutojnë për t'i marrë përgjegjësitë në një situatë të tillë dhe paraprakisht është menduar të bëhen gati 6 qendra pritëse, të cilat mund të vendosen në jug të vendit në kufi me Greqinë. Ndërkohë sipas të dhënave nga të njëjtat burime pritet që në Shqipëri të drejtohen rreth 30 mijë refugjatë. Edhe në Korçë, në afërsi të pikës kufitare është duke u ngritur baza e parë e refugjatëve, ndërsa më në thellësi të territorit është menduar fusha e aviacionit në Gjadër, ku parashikohet të grumbullohen në kampingje më shumë se 5 mijë persona.



Reka sqarohet për idenë e tij që Serbia të kalojë transit përmes Kosovës në detin Adriatik



Partitë opozitare, PDK-ja, AAK-ja dhe Nisma Socialdemokrate, kanë dalë kundër idesë së ministrit të Integrimit Evropian, Blerim Reka, që në këmbim të ulësës së Kosovës në OKB, Kosova t'i lejojë Serbisë kalimin transit nëpër autostradë për në detin Adriatik. Reka përmes një reagimi për media ka theksuar se ky nuk është qëndrim i qeverisë, por një mendim i tij personal, duke bërë të qartë se mbron qëndrimin e kryeministrit Kurti për reciprocitet me Serbinë

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 8 MARS - Anëtari i Kryesisë së Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Migjen Kelmendi, ka mbajtur të dielën një konferencë për media rreth propozimit të ministrit të qeverisë Kurti, Blerim Reka, për hapjen e korridorit për daljen e Serbisë në Durrës, në detin Adriatik në këmbim të ulësës së Kosovës në OKB.

Kelmendi ka thënë se një ide e tillë është e rrezikshme dhe e vdekur qysh në shekullin e kaluar.

Ai ka pohuar se ky incident politik kërkon përgjegjësi institucionale dhe dorëheqjen e ministrit Blerim Reka. "Sikur z. Reka të kishte reaguar në cilësinë e qytetarit, rihapja e kësaj teze kishte me qenë në domenin e përgjegjësive të tij. Por incidenti politik, tragjika e rihapjes së kësaj teze fantazmë

është se z. Reka sot flet si ministër i qeverisë Kurti, politikan që ka marrë përgjegjësi publike para qytetarëve dhe është betuar në llogaridhënie. Andaj ky ministër duhet të japë dorëheqje dhe qeveria të marrë përgjegjësi", ka thënë Kelmendi. Zyrtari i lartë i PDK-së, po ashtu, foli për veprimet e qeverisë Kurti në raport me dëmtimin e marrëdhënieve me ShBA-në, duke theksuar se Qeveria e Kosovës, në mungesë të vizionit dhe guximit për t'u ballafaquar me sfidat që ka para vetes, po hapë tema që janë varrosur një shekull më parë.

Ndërkaq ministri i Integrimit Evropian (MIE), Blerim Reka, ka reaguar për herë të parë pas kërkesës së opozitës për dorëheqjen e tij në lidhje me idenë e tij që Serbia t'i lejohej dalja transit në Adriatik në këmbim të ulësës së Kosovës në OKB. "Këto ditë pati kritika nga opozita në lidhje me një fjalë

timen në intervistën televizive në emisionin 'Jeta në Kosovë'. Ishte e nxjerrë nga konteksti dhe vetëm pjesa e dytë e përgjigjes në pyetjen: 'A do t'i kërkohej Kosovës me marrëveshjen e Uashingtonit, t'i japim territor Serbisë?' Pas përgjigjes sime, se nuk mund të përgjigjem në pyetje hipotetike, por assesi askush nuk guxon të japë territor për ulësen në OKB, sepse integriteti territorial është i panegociueshëm; në insistimin e gazetares se çka atëherë mund të japim për atë ulëse në OKB, thashë, ndoshta, si ide eventuale që t'i lejojmë Serbisë kalimin transit nëpër autostradën tonë për detin Adriatik", ka shkruar Reka në llogarinë e vet në "Facebook".

Ai ka shtuar se diçka që edhe deri tash i është lejuar Serbisë dhe që është ngritur si ide edhe në kuadër të Procesit të Berlinit që nga viti 2014. "Kjo është e tëra, as nuk është vendim, as

qëndrim i qeverisë, por një mendim i imi personal dhënë në pyetjen konkrete për një çështje konkrete. Asgjë më tepër. "Natyrisht, unë mbrojt qëndrimin e kryeministrit Kurti për reciprocitet me Serbinë si parim i marrëdhënieve dhe marrëveshjeve tona të ardhshme. Gjithçka tjetër vjen në shprehje vetëm më vonë, vetëm më pas", ka thënë Reka. Ai ka theksuar se i duket e pandershme që ata të cilët nuk e kërkuar dorëheqjen e presidentit aktual teksa negocionte zgjidhje territoriale me shkëmbime sekrete, ta kërkojnë tash dorëheqjen e tij. Ndaj deklaratës së Rekës patën reaguar edhe AAK-ja dhe Nisma Socialdemokrate.

Lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka thënë se tashmë ofertimi i heqjes së taksës 100 për qind nga qeveria Kurti pa kontratën finale për njohje reciproke në kufijtë ekzistues po prodhon pasojat e para. "Ministri i Integrimeve Evropiane, Reka, paska propozuar kompromisin me Serbinë e që është dhënia e korridorit të transitit për në Adriatik apo kthimi i Kosovës në Serbi dhe hapja e rrugës që Serbia të futet edhe në Shqipëri.

Kjo ofertë e dytë shkatërruese i mundëson Serbisë që të futet në shqiptari dhe ta realizojë ëndrrën e tyre shekullore për t'i pushtuar tokat e arbitrit", ka thënë Haradinaj në reagimin e tij.

Ish-kryeministri Haradinaj ka thënë se Reka duhet menjëherë të japë dorëheqje para se t'i kërkohej ajo. "Këto deklaratat dhe sjellje të rrezikshme politike të qeverisë së mashtrimit, njëherë me heqje të taksës e tash me ofertën e qasjes në Adriatik, prodhojnë pasojat të nënshtrimit dhe kapitullimit politik", ka deklaruar Haradinaj.

Edhe shefi i grupit parlamentar i Nismës Socialdemokrate, Haxhi Shala, ka kërkuar dorëheqjen e ministrit Reka. "Me lejen e kujt ofron korridore e hap porta detare? Në gjykimin tim kjo është deklarata më skandalozë e dhënë nga një zyrtar shtetëror. Ky plan i Vetëvendosjes, i shpalosur nga ministri i saj, është ëndrra e përhershme e Serbisë së madhe, e cila, për të siguruar dalje në det, ka vrarë e masakruar me qindra-mijëra shqiptarë. Planin e Kral Aleksandrit sot e dëgjuam nga ministri i Kurtit, të cilët janë të gatshëm ta zbatojnë e ta realizojnë ëndrrën e tyre", ka theksuar Shala në reagimin e tij.



ISH-KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ KA PROPOZUAR TË DIELËN KONFERENCË DYDITORE PËR DIALOGUN KOSOVË - SERBI

PRESIDENTI DHE QEVERIA KUNDËRSHTOJNË HARADINAJN PËR KONFERENCËN RRETH DIALOGUT

Presidenti i vendit, Hashim Thaçi, dhe qeveria e kanë kundërshtuar propozimin e liderit të AAK-së, Ramush Haradinaj, për të mbajtur një konferencë dyditore në Kosovë për dakordim rreth dialogut final me Serbinë. Ish-kryeministri Haradinaj ka thënë se tashmë në Kosovë ekzistojnë dy blloqe politike për dialogun që, sipas tij, kanë qasje ta gabueshme. Presidenti Hashim Thaçi ka thënë se ka interes të madh nga njerëz të caktuar ta prishin procesin e arritjes së marrëveshjes me Serbinë. Kurse zëvendëskryeministri Avdullah Hoti ka vlerësuar se Kosova ka institucionet e veta dhe nuk ka nevojë për konferenca rreth dialogut

përpara kualitetit të marrëveshjes. Këtë bllok opozitar e udhëheqë njeriu që kërkonte shkëmbime territoriale, pra presidenti Thaçi. Blloku tjetër i udhëhequr nga Kurti e kryetarja e Kuvendit, Vjosa Osmani, nuk ka kalkulluar mirë, sepse kërkon heqjen e taksës, po ashtu, por pa pajtim me ShBA-në”, ka theksuar ish-kryeministri Haradinaj. Sipas tij, ky bllok politik e injoron momentumin e krijuar duke shënuar proces të ri të dialogut e jo dialog përfundimtar me Serbinë. “Zgjidhja shihet vetëm brenda kufijve politikë të BE-së, duke u varur edhe nga pesë shtetet që nuk e njohin Kosovën, e duke anashkaluar aksionet e pakontestueshme që Amerika i ka në shtetësinë e pavarësinë e Kosovës. Kosova do të pësojë edhe në kohë e kualitet në marrëveshje përfundimtare për njohje reciproke”, ka theksuar Haradinaj. Pas këtij propozimi të Haradinajt, ka reaguar presidenti i vendit Hashim Thaçi. Ai nuk e ka përmendur me emër ish-kryeministrin, por ka thënë se ka interes të madh nga njerëz të caktuar ta prishin

procesin e arritjes së marrëveshjes me Serbinë. “Ka shumë interesim të personave të caktuar që ta pengojnë procesin e arritjes së marrëveshjes përfundimtare të paqes mes Kosovës dhe Serbisë. Prandaj, më lejon ta them përsëri qartë dhe në mënyrë të zëshme: Po flasim për përfundimin e një konflikti shekullor, duke u përqendruar në zhvillim ekonomik, jetë më të mirë për qytetarët tanë dhe njohje reciproke. Asgjë më shumë dhe asgjë më pak”, ka shkruar Thaçi në “Twitter”. Ai ka lartësuar angazhimin e ShBA-së në procesin e dialogut. “Sërisht, roli i ShBA-së është i domosdoshëm. I dërguari i posaçëm, Richard Grenell, është duke bërë një punë të shkëlqyeshme dhe e ka mbështetjen e plotë nga Matt Palmeri. Faleminderit Donald Trump për punën që po bën për paqen në botë!”, ka shkruar ai. Edhe zëvendëskryeministri i parë, Avdullah Hoti, i është kundërpërgjigjur liderit të AAK-së, Ramush Haradinaj. Në profilin e vet në “Facebook”, Hoti ka shkruar se Kosova ka institucionet e veta dhe nuk ka

EPOKA E RE**Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 8 MARS - Ish-kryeministri, njëherësh lider i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka propozuar organizimin e një konference dyditore në vend për t’u pajtuar subjektet politike rreth procesit të dialogut me Serbinë. Ky propozim është kundërshtuar nga presidenti Hashim Thaçi dhe Qeveria e Kosovës. Lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka treguar se një konferencë e tillë, ku do të merrnin pjesë prijësit e partive politike dhe përfaqësuesit e

ShBA-së dhe BE-së, do të ndihmonte në bashkimin e spektrit politik të Kosovës për procesin e dialogut me Serbinë. “Si Aleancë ne kërkojmë që të merremi vesh se kah duam t’ia mbajmë. Propozoj që të thirret një konferencë për Kosovën që të mbahet në Kosovë, e përbërë nga kryetarët e partive politike, por edhe nga udhëheqësit e dialogut ShBA dhe BE. Kjo konferencë e Kosovës në Kosovë do të mund të krijojë një qëndrim unik, që do t’ua lehtësonte ShBA-së dhe BE-së që të pajtohemi për dialogun”, ka thënë Haradinaj në një konferencë për medie të dielën të mbajtur në selinë e AAK-së.

Sipas tij, procesi i marrëveshjes me Serbinë tashmë është komprometuar dhe spektri politik është i përçarë. “Procesi i marrëveshjes me Serbinë është komprometuar. Faktori politik në vend është përçarë, presidenti në njërën anë dhe kryeministri në anën tjetër. Pikërisht për këtë arsye Kosova është bërë subjekt i bisedimeve dhe jo palë në tavolinë”, është shprehur ish-kryeministri Haradinaj. Ndër të tjera, lideri i AAK-së ka thënë se tashmë në Kosovë ekzistojnë dy blloqe politike, ai i presidentit dhe ai i kryeministrit. “Blloku politik që kërkon heqjen e taksës, e vendos përpara kohën

nevojë për konferenca të brendshme e as të jashtme për dialogun. “Kosova ka institucione legjitime të dala nga zgjedhjet demokratike të 6 tetorit, të cilat bartin përgjegjësitë kushtetuese, përfshirë edhe dialogun me vendin fqinj, Serbinë. Nuk ka nevojë për asnjë konferencë për këtë qellim, të brendshme e as të jashtme. Duhet vetëm ushtrim i përgjegjësive kushtetuese nga secili. Kryeministri duhet ta marrë përsipër dialogun ashtu siç e definon edhe aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese. Presidentin duhet të qëndrojë brenda kompetencave të veta kushtetuese”, ka shkruar Horti. Ai ka shtuar se në këtë proces duhet të ketë vetëm transparencë. “Kuvendi duhet të kërkojë transparencë në këtë proces dhe ta mbikëqyrë procesin duke ftuar kryeministrin në raportim të rregullt, por edhe duke nxjerrë rezoluta nëse e sheh të nevojshme ta shprehë qëndrimin e vet për ta kornizuar më qartë dialogun”, ka deklaruar Hoti. Subjektet politike nuk kanë arritur ta kenë një qëndrim të përbashkët për taksën ndaj mallrave serbe dhe dialogun me Serbinë as gjatë seancës së Kuvendit të Kosovës, e cila është mbajtur javën e kaluar. Për disa orë, pozita dhe opozita kanë polemizuar duke prezantuar qëndrimet e tyre për dhe kundër heqjes së taksës ndaj produkteve të mallrave serbe. Në këtë seancë partitë kanë kërkuar unitet për taksën dhe dialogun me Serbinë, por asnjëra prej tyre nuk kanë treguar gatishmëri për një gjë të tillë. Në debatin e gjatë parlamentar vetëm AAK-ja ka kërkuar mbajtjen e taksës, kurse LDK-ja, PDK-ja dhe Nisma kanë kërkuar që kjo çështje të bëhet siç po kërkon ShBA-ja. Ditë më parë kryeministri Albin Kurti ka prezantuar planin e tij për heqje të pjesshme ta taksës ndaj mallrave serbe. Ai ka njoftuar se më 15 mars do të hiqet taksa për lëndën e parë që importohet nga Serbia dhe Bosnjë e Hercegovina. Kurti ka deklaruar se nëse Serbia e ndal fushatën për çnjohje dhe zotohet për heqjen e barrierave jotarifore, nga 1 prilli, taksa do të hiqet prej një periudhe prej 90 ditësh. Nëse Serbia nuk iu përmbahet këtyre zotimeve, sipas Kurtit, nga 15 qershori do të rivendoset taksa 100 për qind dhe do të zbatohet parimi i reciprocitetit. Heqja e pjesshme e taksës nuk është përkrahur nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. I dërguari special i presidenti Trump për dialogun Kosovë - Serbi, Richard Grenell, ka kërkuar heqjen e taksës pa kushte. Sipas tij, me mosheqjen e taksës Kosova po bën gabime serioz.

INSTITUTI EPIK: PROGRAMI I QEVERISË, 217 ZOTIME NË MES TË IDEALES DHE TË PAMUNDURËS

PRISHTINË, 8 MARS (ER) - Qeveria e re e Kosovës është votuar më 3 shkurt 2020, kurse më 6 mars ka miratuar programin 2020-2023 për “Kosovën gjithëpërfshirëse, me drejtësi dhe zhvillim të qëndrueshëm”. Programi prej 46 faqesh është i ndërtuar mbi bazën e marrëveshjes së koalicionit LV-LDK dhe është i organizuar në 12 fusha të qeverisjes. Instituti Epik ka theksuar se ky program synon kompletimin e procesit të shtetbërjes dhe integrimin e plotë të Republikës së Kosovës në kuadër të institucioneve rajonale, evropiane dhe ndërkombëtare. “Programi i Qeverisë është dokument më i rëndësishëm politik pasi që përfaqëson vizionin dhe vullnetin e qeverisë për t’i shtyrë përpara reformat në rrugën tonë integruese. Prandaj, në

publikimin tonë të radhës kemi vendosur ta kthejmë vëmendjen drejt analizimit të programit të qeverisë. Qëllimi i publikimit të radhës është dekonstruktimi i programit të qeverisë nga gjuha abstrakte dhe teknike e tij në infografikat e qarta, të matshme dhe të kuptueshme për publikun e gjerë. Ne shpresojmë se kjo do të ndihmojë në inkurajimin e një diskursi vibrant publik i cili do të kontribuojë në dizajnimin dhe zbatimin e politikave kualitative qeverisëse”, është thënë në komunikatën e Institutit Epik. Ky institut ka identifikuar 217 masa konkrete për të cilat është zotuar Qeveria e Kosovës në kuadër të programit të saj 2020-2023, nga masat e reciprocitetit në dialogun me Serbinë, e deri te gjetja e zgjidhjes për Kartonin e Gjellbër. “Duhet sqaruar që në

fillim që ne kemi tentuar ta bëjmë përzgjedhjen e masave të programit të cilat janë të qarta, konkrete dhe të matshme. Me fjalë të tjera, nuk kemi përfshi masat e programit të cilat në esencë nuk janë masa, por zotime abstrakte, p. sh., do ta konsolidojmë funksionimin e kompanive publike, do ta zbatojmë MSA-në dhe rishikojmë ligjet, strategjitë, politikat. Do të forcojmë e fuqizojmë kapacitetet e institucioneve etj. Po ashtu, nuk kemi përfshirë masat e programit të cilat përbëjnë detyrat e zakonshëm të qeverisë, p. sh., përmirësimi i llogaridhënies ndaj qytetarëve, shpërndarja e granteve për komuna dhe aktivitete të ngjashëm”, është thënë në këtë komunikatë. Sipas Institutit Epik, programi i qeverisë së re është diku në mes

ideales dhe të pamundurës. “Zbatimi i programit do të varet nga disa të panjohura. Si do të financohen të gjitha 217 zotimet? A do të arrijë koalicioni ta ruajë konsensusin politik për ta shtyrë përpara njëkohësisht dialogun me Serbinë, reformën në drejtësi, administratën publike dhe/apo në shëndetësi? A do të ketë qeveria kapacitet të mjaftueshëm teknik dhe ekspertizë për të administruar një program kaq ambicioz? Ne besojmë që sikur në ato pyetje më komplekse të njerëzimit, përgjigjja edhe në këtë rast është: vetëm koha do të tregojë. Sidoqoftë, në ndërkohë, ne besojmë se publikimi ynë i radhës na ka ofruar mjete të mjaftueshme për ta monitoruar punën e qeverisë dhe për të kërkuar llogaridhënie për zotimet e bëra” është thënë në komunikatën e Institutit EPIK.



Bashkurti: Dialogu me Serbinë, sfida e Albin Kurtit

PRISHTINË, 8 MARS - Diplomati shqiptar Lisen Bashkurti, përfaqësues i Këshillit të Ambasadorëve në Shqipëri, në studion e lajmeve të “Ora News” ka komentuar zhvillimet e fundit në Kosovë. Ai e nisi bisedën me letrën dërguar presidentit Trump, ku sqaroi qëllimin e saj. Sipas Bashkurtit, kërkohet që në procesin e dialogut me Serbinë të ruhet integriteti territorial i Kosovës. “Procesi i bisedimeve ka qenë me ulje-ngritje vitet e fundit. Tani duket se ka një rikthim të vëmendjes, ka një ngritje të koncentrimin të politikës së jashtme të Shtëpisë së Bardhë dhe Brukselit. Rikthimi i dialogut duket se është një çështje e përbashkët e faktorëve ndërkombëtarë, shqiptarë dhe serbë. Mesazhi i letrës është se faktori shqiptar mbështet iniciativat e Shtëpisë së Bardhë dhe ka besim tek ajo. Ne si anëtarë të Këshillit të Ambasadorëve se parimet e negocimit që ka kristalizuar paketa Ahtisari, jo rikthim të Kosovës në statusin e para 1999, jo copëtim dhe jo bashkim të Kosovës me një shtet, janë parime bazë për njohjen reciproke me Serbinë. Në letrën e Këshillit Ambasadorial është theksuar jo copëtimin të Kosovës, ajo mbetet një nga parimet kryesore për ruajtjen e paqes dhe stabilitetin. Krizat e



bazuara mbi territorialitetin janë vërtetuar në Ballkan që kanë tensione dhe luftëra. Nëse duam Ballkan të qëndrueshëm, duhet të ruhen kufijtë pa u cenuar duke pasur parasysh edhe kufijtë e Kosovës”, ka theksuar Reka.

Më tej, ai foli dhe për koalicionin midis Vetëvendosjes dhe LDK-së. Sipas Bashkurtit, sfida e përbashkët është dialogu me Serbinë, ndërsa tha se në këtë pikë të dyja palët kanë treguar se kanë të njëjtën qasje. “Koalicioni LV-LDK është në stabilizimin e qeverisjes së tij, ka konstituuar institucionet e veta,

është në proces reformimi të administratës publike. Në politikën e jashtme dhe dialogun me Serbinë, dy partnerët kanë qenë përgjithësisht në një qasje. Kanë pasur nuanca. Natyrisht mbetet sfida e qeverisë Kurti që ta ruajë unitetin politik të koalicionit. Çështja e politikës së jashtme është çështje kombëtare. Dialogu me Serbinë lidhet me të ardhmen e Kosovës. Kurti duhet t’i shmangë gabimet e të shkuarës. Kjo mbetet sfida për qeverinë e Kurtit”, ka thënë Bashkurti.

Ai foli edhe për taksën ndaj

mallrave serbe. Sipas Bashkurtit, taksa ishte një vendim i drejtë i qeverisë së kaluar, sepse u vendos në një moment që Serbia kishte shtuar presionin ndaj Kosovës. Ai thotë se ajo duhet të hiqet gradualisht. “Këtu ka pasur debat shumë të madh. Unë mendoj se është një furtunë në gotë. Tarifa u vendos në rrethana shumë të vështira për Kosovën, kur Serbia rriti revanshin duke shkelur marrëveshjet me Brukselin. Ajo u bë pengesë kryesore, ndërsa një pjesë e marrëveshjes të ratifikuar nuk janë firmosur sepse Serbia nuk e njeh Kosovën. Megjithatë nuk ka

qenë taks e pakushtueshme për Serbinë, mendoj se ka qenë shumë e dobishme për Kosovën. Ajo ka tërhequr vëmendjen e faktorit ndërkombëtar. Tani dinamikat ndryshojnë. Unë mendoj se qeveria Kurti ka bërë dy lëvizje të dobishme, megjithatë taksa u vu menjëherë ajo do të hiqet gradualisht. Nga ana tjetër të shikohet që Serbia duhet t’i plotësojë disa kushte në këmbim të kësaj takse. Këto duhet të jenë konkrete dhe të arritshme. Shikoj një rritje të presionit dhe brenda dhe jashtë Kosovës për heqjen e taksës”, është shprehur ai.

Bashkurti ka theksuar se marrëveshja përfundimtare Kosovë - Serbi do ta parashikonte zgjidhjen e një tërësie problemesh teknike, ekonomike dhe politike. “Marrëveshja do të ketë dy kapituj kryesorë: komponenti ekonomik, ku parashikohen një sërë investimesh ndërkombëtare të huaja. Komponenti i dytë do të jetë në kuadrin politik, ku palët do të shkojnë në reciprocitetin e njohjes midis tyre. Serbia duhet ta ndalojë fushatën agresive për tërheqjen e njohjeve ndërkombëtare të Kosovës, ndërsa nga ana tjetër Kosova duhet të jetë e përgatitur për të realizuar një marrëveshje”, ka deklaruar Bashkurti.

Fillon fushata për barazi gjinore

EPOKA E RE**Qendresa RAMA**

PRISHTINË, 8 MARS - “Lulet janë të bukura, por ne duam barazi gjinore në vendimarrje, në të drejta pronësore, në negociata për paqe dhe në mundësi për punësim”. Kjo është motoja e fushatës për barazi gjinore e filluar nga EULEX-i, në partneritet me Rrjetin e Grave të Kosovës (RRGK) dhe OJQ të Drejtat e Grave në Mitrovicën e Veriut, për ta shënuar Ditën Ndërkombëtare të Gruas. Kjo fushatë përfshin vendosjen e afisheve nëpër tërë Kosovën dhe transmetimin e një videoje me qëllim të rritjes së vetëdijesimit për barazinë gjinore.

Duke folur për këtë fushatë, zëvendës-shëfi i EULEX-it, Cezary Luba, tha: “Mundësitë e barabarta nënkuptojnë të ardhme të barabartë. Viti 2020 ka dëshmuar përparimin e Kosovës në përfshirjen e më shumë grave në proceset e vendimarrjes, përmes zgjedhjes së një gruaje si kryeparlamentare të Kosovës dhe përmes emërimit të pesë grave në krye të ministrive. Kjo rritje e përfaqësimit politik të grave është inkurajuese dhe ne

do të dëshironim të shihnim që kjo praktikë të pasqyrohet në të gjitha nivelet e shoqërisë”.

Zëvendës-shëfi i EULEX-it, po ashtu, e theksoi rëndësinë e qasjes së barabartë të grave në pronë, meqë kjo përfundimisht shpie në fuqizimin ekonomik. “Kjo ndihmon në thyerjen e varësisë që të mbijetuarat e dhunës në familje mund ta kenë prej atyre që ushtrojnë dhunë kundër tyre”, tha Luba.

Tijana Simic LaValley, drejtoreshë e programit në OJQ-në të Drejtat e Grave, ka thënë që hulumtimet tregojnë se përfshirja e grave në negociata për paqe i rritë mundësitë e rezultateve të suksesshme me 64 për qind. “Ato kanë qasje humaniste, çka i thekson nevojat e personave të prekur nga konfliktet. Në zemrat e grave ka paqe, jo luftë. Andaj, është e domosdoshme që gratë të përfshihen në negociata për paqe”, ka thënë LaValley.

Kjo fushatë është pjesë e angazhimit të EULEX-it për çështjet gjinore. Që nga qershori i vitit 2018, kur ka përfunduar mandati ekzekutiv i EULEX-it në gjyqësor, misioni bën monitorimin e rasteve të dhunës në baza gjinore përgjatë

**LULET JANË
TË BUKURA,
POR NE DUAM:**



tërë zinxhirit të drejtësisë penale, nga hetimet deri te ndjekjet penale, monitorimi i seancave nëpër gjykata dhe ekzekutimi i dënimeve, si dhe u jep rekomandime autoriteteve të Kosovës për përmirësimin e trajtimit të atyre rasteve.



Përveç kësaj, EULEX-i, në partneritet me Institutin e Mjekësisë Ligjore, është duke e udhëhequr fushatën “Ma thuaj me kohë”, e cila ka të bëjë me rëndësinë e ruajtjes së provave biologjike në rastet e dhunës seksuale për ta vërtetuar

ndodhjen e veprës dhe për t’i sjellë kryerësit para drejtësisë. Deri më tani, rreth 800 nxënës të 17 shkollave fillore dhe të mesme i kanë vijuar ligjëratat e mbajtura nga ekspertë të Institutit të Mjekësisë Ligjore dhe nga Policia e Kosovës.

Edhe në Kosovë është shënuar Dita Ndërkombëtare e Gruas

Vetëm 13.7 për qind e grave janë të punësuar në tregun e punës në Kosovë

Të dielën në kryeqytet është mbajtur marshi tradicional “Marshojmë, s’festojmë” nën organizimin e Rrjetit të Gruas, që ka për qëllim ngritjen e vetëdijes për të drejtat e grave, barazisë gjinore, shoqërore dhe ekonomike. Nga ky aktivitet u tha se vetëm 13.7 për qind të grave janë të punësuar në tregun e punës në Kosovë. Ndërkaq liderët e shtetit dhe ata partiakë përmes rrjeteve sociale kanë uruar për Ditën Ndërkombëtare të Gruas, duke theksuar se duhet edhe për më shumë barazi dhe trajtim të drejtë të gruas në të gjitha fushat e jetës

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 8 MARS - Të dielën është shënuar Dita Ndërkombëtare e Gruas përmes marsheve dhe aktiviteteve të shumta që bëjnë thirrje për barazi dhe fuqizim të gruas kudo në botë. Në Prishtinë është mbajtur marshi tradicional “Marshojmë, s’festojmë” nën organizimin e Rrjetit të Gruas, që ka për qëllim ngritjen e vetëdijes për të drejtat e grave, barazisë gjinore, shoqërore dhe ekonomike. Me thirrjet “Po du me punu pa më ngacmu”, “S’du lule, por du kontratë”, një numër i grave kanë marshuar nëpër qendër të kryeqytetit, në mesin e të cilave u bashkëngjiten edhe liderë institucionalë. “Vetëm 13.7 për qind të grave janë të punësuar në tregun e punës në Kosovë, edhe kur janë të punësuar, gratë vazhdojnë të mbajnë pozita më të ulëta, të paguhen më pak për punë të njëjtë krahasuar me burrat, të ngacmohen seksualisht dhe diskriminohen, të ngacmohen

seksualisht dhe diskriminohen dhe përjashtohen nga puna për shkak të politikave të dobëta institucionale që nuk i mbrojnë të drejtat fundamentale të grave”, ka thënë Xhejlane Loka, përfaqësuese e marshit. Edhe Ambasada Amerikane në Prishtinë ka shpërndarë një fotografi të grave deputete të legjislaturës së re në Kuvendin e Kosovës në krye me kryeparlamentaren Vjosa Osmani, duke theksuar se Kosova ka shumë gra që po punojnë për ta bërë ndryshimin. Ndërkaq liderët e shtetit dhe ata partiakë përmes rrjeteve sociale kanë uruar për Ditën Ndërkombëtare të Gruas. Presidenti i vendit, Hashim Thaçi, ka thënë se në Ditën Ndërkombëtare të Gruas duhet që bashkë të zotohemi për më shumë barazi dhe trajtim të drejtë të gruas në të gjitha fushat e jetës. “Jam krenar me shumë gra të Kosovës, që janë zëri dhe fytyra më e mirë e popullit tonë në botë: në art, sport, shkencë e shumë fusha të tjera. Nderimi ndaj jush është i pafund. Urime 8 Marsi!”,



ka shkruar Thaçi në llogarinë e vet në “Facebook”. Kryetarja e Kuvendit të Kosovës, Vjosa Osmani, në konferencën e organizuar nga Forca e Sigurisë së Kosovës me rastin e 8 Marsit - Ditës së Gruas, me temën “Fuqizimi i gruas në institucione dhe roli i saj në zhvillimin e shtetit”, ka kërkuar që të gjithë së bashku të japim kontribut në fuqizimin e gruas. “Ne duhet të ndihemi të kënaqura me rolin tonë në qoftë se pozicioni publik që e ndajmë na ka mundësuar që në radhë të parë ta ngrehim zërin për problemet me të cilat ballafaqohen gratë dhe vajzat në shoqërinë tonë dhe së dyti që të mos mbetet vetëm zë e mos të mbetet në letër, por të marrim vendime konkrete që fuqizojnë rolin e gruas në shoqëri”, ka thënë Osmani. Kryeparlamentarja ka kërkuar që mos të lejojmë që gratë të mos trajtohen si duhet në profesionet e tyre. “Sot nuk duhet të lejojmë që në Kosovë,

në cilindo profesion, gruaja të mos trajtohet si duhet dhe si jo punëtore”, ka deklaruar Osmani. Kryeministri Albin Kurti ka thënë se Dita Ndërkombëtare e Gruas, 8 Marsi, është dita e cila na e përkujton që për çdo ditë ka shkelje të të drejtave të gruas. Kurti përmes një postimi në llogarinë e vet në “Facebook” ka shkruar se këtë vit si qeveri kanë bërë një hap para. “Për herë të parë në institucione të vendit ka pjesëmarrje më të madhe të grave”, ka shkruar kryeministri. Kurti ka theksuar se barazia gjinore nuk duhet të jetë vetëm në ligje e rregullore të cilat mbesin tekste në letër, por pjesë e përditshme e jetës praktike e të gjithë neve. Edhe kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli, ka uruar të gjitha nënat, motrat dhe vajzat me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Gruas. Veseli ka thënë se përulën ndaj të gjitha grave, sidomos atyre që kanë luftuar për lirinë e Kosovës. “Për 8 Mars, Ditën Ndërkombëtare të Grave, urime për të gjitha nënat, motrat e vajzat tona. Në këtë ditë lartësojmë rolin vendimtar të grave në shoqëri jo vetëm si nëna që edukojnë brezat e ardhshëm, por edhe si protagoniste në çdo sferë të jetës. Përulemi ndaj të gjitha grave që kanë luftuar për liri dhe që kanë bartur mbi supet një pjesë të përpjekjes së popullit tonë për ta ruajtur identitetin kombëtar dhe për t’i fituar të drejtat e veta. Duke ua uruar këtë festë, ritheksoj zotimin tim për t’u angazhuar në fuqizimin politik, ekonomik dhe social të grave në mënyrë që gratë ta marrin vendin e

merituar në shoqërinë e Kosovës”, ka shkruar Veseli në llogarinë e vet në “Facebook”. Ish-kryeministri i Kosovës dhe lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj, me rastin e 8 Marsit, ka thënë se populli shqiptar historikisht ka sakrifikuar jashtëzakonisht shumë, ndërsa gruaja ka qenë shtylla në përballje me sfidat nëpër të cilat kemi kaluar. “Shoqëria jonë ka përparuar në respektimin e të drejtave të grave, por sigurisht se ka edhe shumë punë për t’u bërë. Na takon të gjithë neve që të angazhohemi në forcimin e rolit të gruas në familje dhe shoqëri. Le të na shërbejë dita e sotme si pikënisje dhe inspirim për secilin prej nesh për të punuar shumë në këtë drejtim”, ka shkruar Haradinaj. Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Gruas, edhe kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka uruar të gjitha nënat dhe gratë shqiptare. “Të gjitha nënave dhe grave shqiptare, Gëzuar 8 Marsin - Ditën Ndërkombëtare të Gruas, me shpresën, dëshirën dhe vullnetin që pozita e tyre sociale të jetë në nivelet më meritore të mundshme”, ka shkruar Limaj në “Facebook”. Ai ka thënë se duhet shprehur mirënjohje të thellë për gratë fisnike, që ndër vite me mund e përkushtim kanë ngritur familjen, kanë fituar shumë sfida në funksion të përmirësimit të rolit të tyre në shoqëri, duke u kthyer kështu në një shtyllë të fuqishme të zhvillimit e shtetndërtimit. “Në këtë ditë të veçantë, me shumë nder e krenari kujtojmë sakrificën e shumë grave të cilat u flijuan për lirinë e Kosovës”, ka shkruar Limaj.



Kujtesë historike: Si i njoha Shaban, Hamëz e Adem Jasharin?



Prof. Agim ZOGAJ

Në Kullën e Jasharëve legjendarë

Dalja e parë publike e UÇK-së, më 28 nëntor 1997 për popullin e Kosovës, ishte paralajmërimi më i fuqishëm se çlirimi nga sundimi serb-jugosllav ishte afër. Në fakt, paraqitja e parë publike e UÇK-së i bëri me dije popullit të Kosovës se, nga gjiri i saj kishte lindur, dalëzotësja e idealeve çlirimtare të popullit tonë, ushtria shqiptare e cila i kishte dalë përballë armikut serb.

Zemrat dhe shpirtrat e gjithëshqiptarëve, jo vetëm në Kosovë, pas atij 28 Nëntori të Tretë Shqiptar u përndezen, u lumturuan, sepse stërnipat e Gjergj Kastriotit, Ismail Qemalit, Abdyl Frashërit, Sylejman Vokshit Mit'hat Frashërit, Azem Bejtës, Hasan Prishtinës, Bajram Currit, Shaban Polluzhës, Zahir Pajazitit, Adem Demaçit i kishin rrokur armët në duar dhe po luftonin për çlirim, liri dhe për bashkim kombëtar. Ndërkohë, 22 janari i viti 1998, në qendër të vëmendjes së zhvillimeve në Kosovë e solli familjen Jashari nga Prekazi i Drenicës.

Në mëngjesin e hershëm të 22 janarit të 1998-ës, forca të mëdha ushtarake, paraushtarake dhe policore të okupatorit serb-jugosllav sulmuan me arsenal të fuqishëm të armatimit familjen trime të Jasharëve. Shumë shpejt, historia e atij sulmi barbar serb dhe njëherazi historia e qëndresës heroike e të pamposhtur të kryefamiljarit të Jasharëve, Shaban Murat Jashari me djemtë e tij trima, Hamzën, Ademin dhe familjarët e tjerë, u bënë lajm qendror politik, kombëtar në Kosovën e asaj kohe. Mbi të gjitha, në popull, me shumë dashamirësi u prit dhe u nderua qëndresa, lufta, beteja heroike dhe guximi i jashtëzakonshëm i Jasharëve për t'u përballur me armikun serb.

Ajo betejë e madhe e familjes Jashari, e cila i dha frymëzim tërë lëvizjes sonë kombëtare në Kosovë dhe më gjerë anë e mban shqiptarisë, ishte një zgjim i yni kombëtar, dëshmi se, shqiptari është i vendosur që, me jetë a vdekje ta mbrojë prapen e shtëpisë dhe lirinë e vetë. Ndërkohë, pas 22 janarit 1998 thuajse e tërë Kosova, i madh i vogël u drejtuan kah Drenica jonë heroike për t'i dhënë përkrahje morale trimave të Jasharëve, në Prekazin heroik, në Djepin e legjendave, në tokën e larë nga lotët dhe gjaku, gjatë historisë, të mbushur me varre! Ishte ai, një solidarizim i jashtëzakonshëm i popullit tonë me guximin dhe

trimërinë e një prej familjeve e cila, si dikur në kohërat e Skënderbeut, ishte shndërruar në një nga legjendat e popullit tonë heroik. Kryetrimi, Adem Jashari, me babanë Shabanin, vëllanë Hamzën dhe bashkëluftëtarët, edhe para 5 marsit 1998, në betejat kundër pushtuesve serbë, e kishin ngritur lartë, Flamurin e Lirisë! Shkëlqimi ademian, ndërsa, ishte bërë një shkëlqim mitik, më tepër se hyjnorë, sikur në epokën e Gjergjit tonë!

Më 24 janar 1998 kisha nderin e jashtëzakonshëm që ta vizitoja familjen Jashari në Prekaz, të bashkëbisedoja me trimat e lirisë, duke qëndruar në Kullën e Jasharve për afro tri orë. Në Skenderaj, në orët e hershme të paradites së 24 janarit 1998, mua dhe kolegët nga javorja politike shqiptare "Zëri" na prit, drenicasi, Remzi Bunjaku me të cilin u nisëm drejt Kullës së Jasharëve. Ishim nisur me mision që ta regjistronim rrëfimin për historinë e familjes Jashari, prandaj, sidomos, duke pasur informacion për luftën e Jasharëve kundër forcave serbe, isha shumë kureshtar që t'i takoja drejtpërdrejt.

Me të arritur tek hyrja e Kullës, takuam një numër të madh të bashkëkombësve të cilët kishin ardhur nga të gjitha viset e Kosovës dhe prisnin në rend për të hyrë në odën e Jasharëve. Meqenëse mikpritësi ynë, e kishte paralajmëruar vizitën tonë, nuk vonoi shumë dhe dikush nga djelmoshat e rinj, të cilët mbanin rendin, na tha se mund të ngjiteshim lartë, shkallëve për të hyrë në odë. Oda ishte e mbushur përplot me vizitorë, luftëtarë, kurse në ballë të odës po qëndronte kryeplaku Shaban Murat Jashari. Të pranishmit shprehnin solidarizim për luftën e Jasharëve kundër hordhive serbe. Meqë, mysafirët ndërroreshin nga çasti në çast, në odë mbretëronte një atmosferë sikur në legjendat shqiptare. Ndjehej një atmosferë trimërie, guximi, qëndrese për ta çliruar, Atdheun me çdo kusht. Në ato çaste, jo vetëm nga fjalët e atyre burrave e trimave drenicarë, por, edhe nga shikimet, e nganjëherë edhe nga heshtja e tyre, e ndjeja se lufta frontale kundër Serbisë, po afronte. I madh e i vogël ishin bërë gati për betejën vendimtare... Gjatë tërë kohës sa ishim në odë, në ballë të së cilës qëndronte flamuri kombëtar, kryeplaku Shaban Murat Jashari rrinte në heshtje dhe rrallë e fliste ndonjë fjalë. Ai e parandiente se, në marsin e krenarisë, së bashku me djemtë trima, nipat, mbesat, gratë kreshnike të shtëpisë, nën emblemën e ndritur të UÇK-së, do ta fillonte luftën, betejën vendimtare kundër hordhive serbe! Shaban Murat Jashari, e dinte se, Atdheu nuk ka çmim!

Pas një kohe, dola nga oda, sepse, dikush më tha se do ta takoja Hamëz Jasharin, të cilin,

ende, nuk e njihja. Zbrita shkallëve, dhe së bashku me disa të rinj, qetësisht, me përshtypje të shumta nga ambienti, ku për herë të parë e shihja UÇK-në, po ecja prapa, një personi i cili, kishte të veshur një pallto ngjyrë hiri. Kaluam nëpër oborr dhe, përmes disa shkallë të tjera arritëm në objektin tjetër të kompleksit të Kullës së Jasharëve. Për një çast, dikush më pëshpëriti në vesh se, personi i përmendur ishte Hamëz Jashari, nga i cili do ta regjistroja rrëfimin për historinë e familjes Jashari, për luftërat, qëndresat që, heroikisht, u kishin bërë pushtuesve, hordhive serbe.

Kisha hyrë në dhomën, e cila në fakt ishte dhoma e ndejës për familjarët e Hamzës. Më duhet ta pranoj, edhe sot, se në ato çaste ndjeja një emocion shumë të veçantë. Sidoqoftë, po e kuptoja, ndjeja se gjendesha në një familje me histori dhe me traditë të thellë të atdhetarisë, dhe se, për dallim nga Prishtina e përgjumur e atyre kohërave, e zbehur dhe e pashpirt, në odën, në oborrin e Jasharëve, po e ndjeja veten shumë më i trimëruar, shumë më afër dhe më i vendosur që, të kërkoja t'iu bashkëngjitesha djemve të UÇK-së! Nuk më shkonte mendja, se vetëm disa muaj pas kësaj vizite, në cilësi të korrespondentit të Programit shqip të Radios Gjermane "Detutsche Welle" do të raportoja për luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, luftën e ushtrisë së lavdishme të popullit tim, kryekomandant legjendar i të cilës ishte, Adem Jashari.

Adem Jashari me shikimin skenderbegian

Posa u ula, Hamëz Jashari e hoqi pallton ngjyrë të gjelbër dhe, para syve të mi u shfaqën emblemat e UÇK-së. Ai, e vërejtë se po e shikoja me plot emocion lumturie. Në murin e bardhë, afër dritares, prej nga shihej pikëqëndrimi i forcave serbe, te Fabrika e Municioneve, ishin të vendosur tre automatikë, ndërsa nëpër dhomë, e sidomos prapa derës, kishte municion të llojeve të ndryshme, fishekë dhe bomba dore. Në ato çaste, po e kuptoja dhe po e ndjeja se, isha në çerdhen e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në çerdhen e kryengritësve shqiptarë. Me ngadalë, me qetësi dhe me një urti shqiptare, Hamëz Jashari, ai trim Drenice, nisi të rrëfente për historinë e familjes Jashari, nga katragjyshi, gjyshëritë dhe deri te kontributi atdhetar i, kryeplakut, Shaban Murat Jashari. Pas rrëfimit mbresëlënës, gati tre orësh, erdhi koha për t'u larguar nga Kulla e Jasharëve, pa e parandie se, aty po shkruhej historia e lirisë së vendit tim, deri asaj pranvere, Kosova jonë, tokë e robëruar!

Përmes shkallëve, zbritëm për në oborr, ndërkohë që i shikoja muret e plasaritura nga granatat dhe nga plumbat e okupatorit serb, gjurmët e luftës së 22 janarit

1998. Në oborrin e Jasharëve po shikoja pamje të jashtëzakonshme. Adem Jashari, kryekomandanti i UÇK-së, i veshur me uniformë lufte, të UÇK-së po qëndronte i rrethuar nga një grup pjesëtarësh të UÇK-së, djem të rinj Kosove, asnjëri prej të cilëve, nuk i kishte mbushur as të njëzetat. Pamje, për histori!

U përshëndetëm, për herë të parë dhe të fundit! Adem Jashari, i kishte vënë duart prapa shpinës kurse, me një shikim të reptë, skënderbegian, mitik dhe po aq hyjnor, e lëshonte vërtetimin e tij, në drejtim të fabrikës së municionit prej nga, vetëm dy mëngjese më parë kishin ardhur sulmet e agresorit serb. Ai trim shqiptar, sytë të mburur, së bashku me kryeplakun Shabanin, vëllanë Hamzën dhe trima të tjerë, me guximin e heroit dhe me pamjen, që në ato momente më ngjante me Azem Bejtën, sikur i bënte me dije Serbisë se, ai për jetë a vdekje nuk e lëshon kullën e të parëve. Në fakt, në ato çaste, kur vetëm disa metra përballë e kisha Adem Jasharin, e në të majtë të krahut tim ishte, Hamëz Jashari, si kurrë më parë, e ndjeja se isha në çerdhen e kryengritësve shqiptarë, nën mbrojtjen e UÇK-së. Për herë të parë, shumë afër dhe thellë në perceptim po e ndjeja erën e luftës, aromën e gjakut dhe të varreve! Ishte një ndjenjë, mes të vërtetës dhe legjendës. Jasharët trima, të pamposhtur nga armiku serb, po bëheshin gati për luftën vendimtare, luftën e UÇK-së, luftë, të urdhëruar edhe nga Zoti. Ndjenjë e pa përshkruar më ishte ngulitur në shpirt, aq më parë, sepse, asaj dite janari, derisa qielli ishte nxirë, në oborrin e Jasharëve po e ndjeja veten të sigurt, të trimëruar, si kur më parë.

Po flisja me UÇK-në

Hamëz Jashari më tha: Mik, ky është Ademi për të cilin të folja në dhomë, i dënuar nga Serbia me 20 vjet burg në mungesë. Në ato çaste, derisa me Ademin e bëmë nga një përshëndetje nderimi, më bënte përshtypje të thellë qëndrimi dhe pozicioni ushtarak i krye heroit të kohërave moderne shqiptare, i cili, i veshur me uniformën e UÇK-së sikur mezi priste ballafaqimin e radhës me forcat okupatore serbe/jugosllave. Derisa po e përcillja, po e sodisja tërë atë atmosferë në oborrin e Jasharëve, me aq shumë ardhje e vajtje të bashkëkombësve tanë nga të gjitha viset e Kosovës, në mendjen time përpiquesha t'i rendisja rrëfimet e Hamzës për historinë e Jasharëve. Dhe derisa, në atë mesditë me qiell të trazuar, përpiquesha ta ndjeja fuqinë magjepse në shikimin plumb të Adem Jasharit, përfundimisht e kuptova se, djepi i lirisë dhe i çlirimit të Kosovës nuk ishte në Prishtinë, por në Prekazin e Drenicës, se UÇK-ja, jo vetëm që

ishte realitet, por ishte vetë shpirti kryengritës, dalzotës i popullit martir të Kosovës. Po e shihja, po e ndjeja, po e prekja, po flisja me UÇK-në, pa e ditur se më shumë se një muaj nga dita e vizitës sime në Kullën e Jasharëve do të fillonte beteja vendimtare për lirinë tonë, Epopeja e 5, 6, 7 marsit të 1998, Epopeja e Jasharëve legjendar, Epopeja e UÇK-së së përndritur! Adem Jashari, po e mbante në dorë zjarrin kryengritës për ta ndezur, anë e mban Atdheut Kosovë, flakën e lirisë!

Duke u përshëndetur dhe duke u përqaftuar me Hamëz Jasharin, sikur të ishim njohur 100 vjet jetë, e pyeta: Saka shtrirje UÇK-ja përveç në Drenicë? Hamëza, përherë i urtë dhe guximtar, më shikoi i qetë, e lëshoi një buzëqeshje melankolike, ashtu siç ka ditur ai, me plot siguri e krenari më tha: UÇK-ja është në tërë Kosovën! Por, sikur nuk u mjaftua me këtë dhe vazhdoi të fliste: Thuaju atyre në Prishtinë se nuk ka liri, se nuk ka çlirim të Kosovës pa luftë, se lirinë, e sjellë UÇK-ja e dalë nga shpirti i popullit, nga betimi në gjakun, gjuhën, tokën shqiptare, Flamurin e Arbërit!

Derisa, Hamzës, po ia shtrëngoja duart, ndërkohë, e vrojtoja pamjen legjendare të kryekomandantit të UÇK-së, Adem Jasharit, i cili, sikur donte të thoshte se, liria është në zemrat, në shpirtin, në guximin e secilit shqiptar, Kosovë, je gjaku ynë që nuk falesh! Megjithatë, në atë çast historie, pasi, Hamzës, ia vendosa, në xhepin e majtë të xhakës me emblemën e UÇK-së, një kartëvizitë, ia bëra pyetjen e fundit: Pra, më thuaj o trim Drenice, a do të ketë luftë në Kosovë? Hamëza, e lëshoi një shikim drejt Ademit, mua ndërsa, më pa përballë, e mbështeti dorën mbi krahun tim të djathtë dhe në mënyrë të prerë më tha: Do të ketë luftë, do të ketë luftë, sepse, o mik i ynë, Kosova nuk çlirohet pa luftë!

Heshtje dhe ankth, papritmas, një tufë zogjsh shtegtarë, krejt të trembur, fluturuan drejt kësaj cope të qiellit të përndeaur shqiptar, i cili, i tëri, nga shkëlqimi i ylberit, ishte bërë flakë e vetëtimë... Tani më, nën emblemën e UÇK-së, të kryetrimin Adem Jashari me bashkëluftëtarë, Drenica e përgjakur, e kishte lindur lirinë e Kosovës... Liria, emrin e kishte, Atdhe, Republika e Kosovës!

Rrugës për në kryeqytet, kisha ndjenjën se, po më përcillte një jehonë e këngëve kreshnike shqiptare: O prite, prite, trim Adem Jasharin me bashkëluftëtarë e UÇK-së! Më tej, balada e historisë shqiptare thoshte: Nuk ka lavdi më të madhe sesa të vdesësh për liri! Vetëm ata janë vetë historia e lirisë!

Po agonte një ditë e re...

(Marrë nga Neogazeta)

Programi i qeverisë, pa strategji afatgjatë

Prishtinë, 8 mars - Qeveria e Kosovës ka paraqitur programin qeverisës 2020-2023, i cili shënohet se në fokus ka zhvillimin ekonomik, hapjen e vendeve të reja të punës, tërheqjen e investimeve të huaja dhe luftimin e dukurive negative, siç është informaliteti që pengon ekonominë. Programi qeverisës 2020-2023 është votuar në mbledhjen e fundit të Qeverisë së Kosovës. Në pika të shkurtra këtë program e kanë shpalosur zyrtarë të qeverisë si dhe kryeministri i Kosovës, Albin Kurti.

E para shtyllë e këtij programi, sipas kryeministrit Kurti, konsiston në zotimin për t'i luftuar në mënyrë të pakompromis korrupsionin dhe krimin e organizuar dhe, shtylla e dytë, si prioritet kryesor ka rritjen ekonomike, zgjerimin e investimeve dhe krijimin e vendeve të punës.

Ekspertë të çështjeve ekonomike dhe përfaqësues të bizneseve në Kosovë e konsiderojnë një program i cili do të mund të realizohet nëse zbatimi i tij do ta merrte seriozitetin e plotë nga dikasteret e qeverisë. Drejtori ekzekutiv i Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë, Arian Zeka, tha për "Radion Evropa e Lirë" se pikat e programit qeverisës të paraqitura nga kryeministri Kurti janë përgjigje në shumë aspekte ndaj kërkesave të komunitetit të

biznesit dhe shoqërisë civile të paraqitura përgjatë viteve. "Fuqizimi i sundimit të rendit dhe ligjit, luftimi i korrupsionit, luftimi i ekonomisë joformale si dhe përmirësimi i zbatueshmërisë së kontratave përmes krijimit të gjykatës komerciale, të gjitha këto të paraqitura në programin qeverisës, janë gjëra të cilat do të ndihmonin në përmirësimin e imazhit të vendit para investitorëve të huaj dhe krijimin e një mjedisi të barabartë ku bizneset në Kosovë do të trajtoheshin barabartë. Një mjedis i tillë i barabartë nuk ka qenë në të kaluarën", thotë Zeka.

Luftimi i ekonomisë joformale, luftimi i korrupsionit si dhe krijimi i vendeve të reja të punës kanë qenë prioritetet edhe në programet e qeverive të kaluara, thotë Zeka por, sipas tij, rezultatet nuk kanë qenë të kënaqshme. Zeka thotë se sa i përket fuqizimit të kapaciteteve të brendshme prodhuese, është ndjekur një politikë dinamike fiskale edhe nga qeveritë e kaluara duke krijuar lehtësira për gati të gjitha lëndët e para që përdoren nga industria prodhuese si dhe janë liruar nga tatimet, por qasja në financë e bizneseve prodhuese, thekson ai, vazhdon të mbetet problematike. "Ne si Odë Ekonomike Amerikane në Kosovë kemi sugjeruar që qeveria e re të bashkëpunojë me Fondin Kosovar për Garantimin



Kreditor ashtu që të ketë një linjë të veçantë për prodhuesit për t'iu dhënë mbështetje kurdo që aplikojnë për financim në institucionet financiare vendore", thotë Zeka.

Në anën tjetër, profesori i makroekonomisë, Musa Limani, thotë për "Radion Evropa e Lirë" se para programit qeverisës, Qeveria e Kosovës ishte dashur të krijojë një strategji afatgjatë të zhvillimit, pasi që programi nuk ka mbështetje afatgjatë zhvillimore. "Nga aspekti makroekonomik unë mendoj që programi qeverisës duhet të dalë nga strategjia e zhvillimit afatgjatë e

Kosovës. Mendoj se qeveria aktuale duhet ta bëjë strategjinë e zhvillimit afatgjatë që në këtë moment duhet ta përfshijë periudhën 2020-2029. Nga strategjia si dokument madhor, duhet të mbështetet zhvillimi i ardhshëm i Kosovës dhe të nxirren planet vijuese, njëvjeçare dhe pesëvjeçare", thotë profesor Limani.

Limani thotë se Qeveria e Kosovës me instrumentet e politikës fiskale, politikës tregtare dhe kreditore duhet ta mbështesë sektorin privat, në mënyrë që të krijohet një ambient i mirë afarist. "Për të pasur një zhvillim më të hovshëm ekonomik duhet

mbështetje në tërheqjen e investimeve të huaja, në veçanti të diasporës shqiptare. Duhet të krijohen kushte dhe parakushte për këto investime. Diaspora është e gatshme të investojë në Kosovë, por asnjë qeveri nuk i ka krijuar kushte dhe parakushte për tërheqjen e investimeve të tyre. Kështu që qeveria aktuale duhet t'i japë prioritet diasporës", thotë Limani.

Qeveria e re e Kosovës, e udhëhequr nga kryeministri Albin Kurti, u zgjodh më 3 shkurt. Kjo qeveri ka 15 ministri, dy zëvendëskryeministra dhe pritet të ketë rreth 33 zëvendësministra.

Anulohen fluturimet nga Italia veriore drejt Prishtinës

PRISHTINË, 8 MARS (ER) - Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës "Adem Jashari" ka pezulluar përkohësisht fluturimet që vijnë nga Italia veriore, pas përhapjes së madhe të koronavirusit që mori jetën e 230 personave deri të shtunën, me më shumë se 36 viktima brenda 24 orëve. Ministri i Infrastrukturës, Lumir Abdixhiku, përmes një postimi në rrjetin social "Facebook", ka bërë me dije se vendimi vjen pas pranimit të rekomandimit emergjent nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë për anulimin e të gjitha fluturimeve që vijnë nga zonat epidemike të Italisë së Veriut si refleksion i karantinës së vendosur nga qeveria italiane në betejën kundër koronavirusit. "Si rrjedhojë, kam kërkuar anulimin e përkohshëm të të gjitha

fluturimeve që vijnë nga kjo zonë epidemike, e cilësuar si zonë me risk të lartë. Fluturimet për nga Italia Veriore janë ndërprerë. Ndiejmë keqardhje për masat e marra, por në situatën e tanishme nuk kemi alternativë. Jam në kontakt të ngushtë me ministrin e Shëndetësisë Vitia dhe me ministrin e Punëve të Jashtme, Konjufca, për ta koordinuar kontrollin në aeroport dhe asistencën eventuale ndaj udhëtarëve në zonat e rrezikshmërisë së lartë", ka shkruar Abdixhiku.

Italia ka vendosur 16 milionë njerëz në karantinë derisa po lufton kundër shpërndarjes së koronavirusit. Banorët në 15 provinca qendrore dhe veriore të Italisë duhet të marrin leje për të udhëtuar. Milano dhe Venediku janë tashmë të



përfshira nga ky virus. Shkollat, palestrat, pishinat dhe qendrat e skijimit do të

mbyllen tërësisht si dhe të gjitha ngjarjet publike do të anulohen, tha kryeministri i

Italisë, Giuseppe Conte. Këto masa të jashtëzakonshme do të zgjasin deri më 3 prill.

Veseli fton të rinjtë e Llapit të bashkohen për ndryshime



PODUJEVË, 8 MARS (ER) - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli, ka takuar të rinjtë e Komunës së Podujevës të cilët i ka ftuar ta votojnë Naim Fetahun për kryetar të kësaj komune për, siç ka thënë, nisjen e ndryshimeve të duhura dhe për t'u hapur perspektivë të rinjve llapjanë. Veseli ka thënë se më 15 mars rinia e Podujevës do ta bëjë ndryshimin e nevojshëm dhe do ta vulosë fitoren e Naim Fetahut. "Jam i sigurt më 15 mars me aktivitetin e juaj, me përkushtimin e juaj, me fjalët e juaja, duke shkuar shtëpi për

shtëpi, do t'i vijë e mira Llapit, do t'i vijë e mira Podujevës me Naim Fetahun, kryetar i Komunës së Podujevës. Kështu që, bëhuni bashkë të gjithë, me vetëbesim shumë të madh, se Podujeva ka nevojë për ndryshim", ka thënë Veseli, duke shtuar se ka largim të njerëzve, të rinjve dhe ndërmarrësve nga Podujeva për shkak të mungesës së perspektivës. Ndërsa kandidati për kryetar të Podujevës, Naim Fetahu, ka thënë se programi i tij është i fokusuar në fuqizimin e të rinjve të kësaj komune.

Bulliçi: Burica dhe Tërrnava, me zemër për ndryshim

PODUJEVË, 8 MARS (ER) - Kandidati për kryetar të Podujevës nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje, Shpejtim Bulliçi, është duke vazhduar fushatën zgjedhore në çdo fshat dhe lagje të kësaj komune. Në kuadër të zgjedhjeve të 15 marsit, Bulliçi ka qëndruar në fshatin Buricë dhe Tërrnavë, ku është

pritur nga qindra banorë të cilët i kanë dhënë mbështetje. Bulliçi para elektoratit të këtyre dy fshatrave ka shpalosur programin dhe vizionin e tij për udhëheqjen e Komunës së Podujevës. "Në tubimet e sotme në Buricë dhe Tërrnavë shihej atmosferë e përzemërt me qytetarët që kanë vendosur

për numrin 12, numrin fitues të zgjedhjeve të jashtëzakonshme në Podujevë. Kryetari i ardhshëm i komunës, Shpejtim Bulliçi, paraqiti para qytetarëve prioritetet dhe zotimet tona për këtë mandat të mbetur, masat që do t'i ndërmarrim në dobi të qytetarëve", ka njoftuar Vetëvendosje.



Hoti dhe Rudari u ofrojnë mbështetje bizneseve në Podujevë



PODUJEVË, 8 MARS (ER) - Zëvendëskryeministri i parë i Kosovës nga radhët e LDK-së, Avdullah Hoti, ka shoqëruar kandidatin e kësaj partie për kryetar të Podujevës, Nexhmi Rudari, në fushën elektorale për zgjedhjet e 15 marsit. Hoti në llogarinë e vet në "Facebook" ka bërë me dije se me Rudarin janë takuar me përfaqësues të bizneseve të cilëve u kanë premtuar mbështetje të nivelit lokal dhe qendror. "Bashkë me

Nexhmi Rudarin sot takuam disa biznese në Podujevë, kryesisht të ndërmarrësve të rinj, ku biseduam për sfidat dhe planet e tyre. I falënderoj të gjithë për praninë. Diskutuam gjerësisht për disa projekte shumë interesante, si për shitjet 'online', për kultivimin dhe shitjen e shafanit. Komuna do t'u qëndrojë afër këtyre bizneseve, krahas mbështetjes nga niveli qendror", ka shkruar Hoti.

Bekim Jashari zotohet se do t'i mbështesë gratë për tejkalimin e sfidave

SKENDERAJ, 8 MARS (ER) - Komuna e Skenderajt, me rastin e shënimit të Ditës së Gruas, 8 Marsit, ka mbajtur një tryezë me temën "Roli dhe pozita e gruas në Komunën e Skenderajt". Në këtë tryezë, kryetari i komunës, Bekim Jashari, pasi ka uruar gratë për 8 Marsin, ka vlerësuar lart kontributin e jashtëzakonshëm të grave shqiptare në edukimin e brezave të rinj. "Gruaja shqiptare çdoherë ka qenë shtylla e shoqërisë dhe kontributi i saj në proceset nëpër të cilat ka kaluar shteti ynë ka qenë dhe mbetet i jashtëzakonshëm", ka thënë Jashari.

Më tutje, Jashari ka thënë se Komuna e Skenderajt ka shënuar hapa pozitivë në arritjen e barazisë gjinore brenda institucioneve vendimmarrëse. Duke theksuar faktin se Kuvendi Komunal i Skenderajt udhëhiqet nga një grua, ai ka thënë se ka gra të cilat janë udhëheqëse të drejtorive të rëndësishme e institucioneve shkollore. "Sot në komunën që unë udhëheq gratë janë pjesë e rëndësishme e vendimmarrjes institucionale, pjesë e udhëheqjes së drejtorive përkatëse. Sot kemi gra në pozita udhëheqëse në komunë, institucione shkollore dhe të tjera vendimmarrëse



në nivelin lokal. Në këtë drejtim në Komunën e Skenderajt kemi gra drejtoresha, e kemi kryesuesen e Kuvendit, e kemi Zyrën Ligjore dhe Zyrën e Prokurimit që udhëhiqen nga gra. Edhe pozita të tjera udhëheqëse kemi që drejtohen nga gra të përgatitura dhe të vendosura që të

kontribuojnë për të mirën e komunës sonë", ka thënë Jashari. Gjatë këtij organizimi gratë janë njoftuar me problemet e ndryshme të cilat ato hasin çdo ditë, duke filluar nga problemet e përditshme brenda familjes e deri te pabarazitë me të cilat ato

ballafaqohen në rrugë apo edhe në vendet e tyre të punës, për të cilat i pari i Komunës së Skenderajt është zotuar se do t'i mbështesë ato për tejkalimin e sfidave. Komuna e Skenderajt po përkrah gratë edhe me subvencione të ndryshme në fushën e bujqësisë dhe fushave të tjera për t'u mundësuar atyre vetëpunësim, por edhe ngritje të nivelit të mirëqenies së tyre. Po ashtu, Komuna e Skenderajt është duke bërë përpjekje që në bashkëpunim me donatorët ta hapë qendrën e gruas në të cilën gratë do të ushtrojnë veprimtari të ndryshme artistike.

TË JESH GRUA



Vlora ÇITAKU

Unë i takoj pakicës fatlume. Të jesh grua në Kosovë nuk është shumë e lehtë. Të jesh grua në funksion të lartë publik, jo vetëm që nuk është e lehtë, por është ende e rrallë. E, të jesh grua, pa mbështetje, pa punë e pa të ardhura, mund të jetë edhe e rrezikshme. Shpeshherë verbërohem i besa edhe vetëkënaqemi me të dhënat dhe të arriturat sipërfaqësore. I përsërisim si recital disa të dhëna, që ndonëse janë hapa përpara, sërish nuk janë të mjaftueshme. Themi vazhdimisht që kemi kuotën prej 30% të grave në Parlament. Me plot krenari themi që jemi vendi që ka pasur presidenten e parë grua në Evropën Juglindore. Që kemi gra

ministre e ambasadore në qendra të rëndësishme. Të arritura këto, padyshim. Por, nëse pak gërryejmë mbi sipërfaqen vezulluese, të dhënat janë shumë shqetësuese. Është dashur të kalojnë 15 vjet dhe të kemi një grua në krye të shtetit që shoqëria jonë të fillojë të flasë hapur për të mbijetuarat e dhunës seksuale gjatë luftës. Kjo heshtje, prej më shumë se një dekade, nuk është bërë për t'i mbrojtur të mbijetuarat. Por për t'i mbrojtur burrat, nga ajo që ata e konsideronin zhburrim të tyre. Plagët e grave nuk kishin rëndësi, por "krenaria" e burrave. Sa për referencë, kujtojeni debatin që e shoqëroi këtë temë në Parlamentin e Kosovës. Tjetra, qasja në pronë dhe trashëgimi. Shifrat janë alarmante. Njëshifrore. Vajzat rrallë e hiç janë pjesë e trashëgimisë së prindërve. E kjo gjeneron një varg problemesh të tjera. Zvogëlon mundësinë për qasje në financa. Zvogëlon mundësinë për pavarësi ekonomike. Ndonëse infrastruktura ligjore edhe në këtë pikë është shumë e

avancuar, norma tradicionale ngadhënjën mbi ligjin. Gratë vullnetshëm heqin dorë nga kjo e drejtë, për të ruajtur harmoninë familjare, që patjetër nënkupton që djali i merr të gjitha. Zaten, edhe populli e thotë: gruaja lind në shtëpi të huaj... sa e turpshme. Sa e papranueshme. Jo çdo gjë që është tradicionale është e mirë, jo çdo normë duhet ruajtur. Përkundrazi, evolucioni shoqëror implikon pikërisht të kundërtën. Nuk mund të ecet përpara pa e sfiduar status-quo-në. Tjetra, dhuna në familje. E kjo, kjo është forma më e vrazhdë e shpërfaqjes së pabarazisë. Pasoja më e dhimbshme e një sistemi të etabluar, ku gruaja hesht, shkelet, rrihet, vritet. Të jem e singertë, edhe në shoqëritë më liberale e të përparuara, ka raste të dhunës ndaj gruas. Por, ajo që bën ndryshimin është si reagon shoqëria, si reagon shteti, si reagon drejtësia. Kam parë dhe kam dëgjuar me sytë e mi intervista të gjyqtarëve dhe prokurorëve, disa prej tyre edhe gra, që ishin të neveritshme,

gati-gati arsyetonin dhunën ndaj grave. "Hajt se një shuplakë ta ka dhënë... nuk është ba nami... nuk shkatërrohet familja për një zënkë...", ishin disa nga fjalët e atyre që kanë dhënë betim për të mbrojtur ligjin dhe dinjitetin njerëzor, të secilit prej nesh, edhe të grave. E turpshme. Nuk po dua të tingëlloj nihiliste. Nuk jam nga ato që shohin vetëm zi. Por, në ditët si kjo, më shumë se të arriturat, ne si gra, si shoqëri, duhet t'ia kujtojmë vetes edhe sa shumë punë kemi përpara. Dhe, nuk po bëj thirrje për kryengritje kundër burrave. Larg asaj. Kjo betejë nuk fitohet me antagonizëm ndaj burrave. Kjo nuk është betejë kundër tyre. Kjo është betejë që duhet ta fitojmë bashkë me ta. Nuk mjafton t'i flasim njëra-tjetrës. Duhet të flasim më shumë me baballarët, vëllezërit, bashkëshortët dhe kolegët tanë. Personalisht, më bëhet zemra mal kur shoh që në Kosovë po rritet numri i feministëve burra. Kur shoh çdo ditë e më shumë burra që sfidojnë moralin e dyfishtë dhe normat e papranueshme që justifikojnë dhunën dhe pabarazinë gjinore.

Prapë po them, për një shoqëri në të cilën pas Luftës së Dytë Botërore, mbi 90% e popullatës nuk dinte shkrim-lexim; për një shoqëri që vazhdimisht ka qenë e shtypur dhe e përjashtuar; për këto pak vite shtet, përparimi është i dukshëm. Por, derisa të mbërrijmë ditën kur një grua, kudo qoftë ajo, në fshat apo në qytet, në politikë apo në biznes, të ndihet e barabartë me burrat në dhomë apo në zyrë, beteja nuk është e përfunduar. E disa prej nesh, që kemi pasur fatin të lindim në një familje të caktuar, në një vend të caktuar, dhe për shkak të këtyre rrethanave, tërësisht jashtë kontrollit tonë, kemi arritur t'i realizojmë ambiciet tona, ne e kemi barrën më të madhe të përgjegjësisë që të punojmë për ato gra që nuk kanë pasur fatin tonë. Unë e di, që sigurisht është diku në Kosovë, një vajzë me emrin Vlorë, që është më e zgjuar se unë, më punëtore se unë, më e zonja se unë, po Vlora nuk ka pasur fatin tim. Ajo, për shkak të rrethanave jashtë kontrollit të saj, nuk mund të ketë mundësitë që kam pasur unë.



NATË



ELIF ŞAFAK

Nëna ime në të katërmbëdhjetat u bë nuse, në të nëntëmbëdhjetat u bë kurban. Nëna ime e bukur, që kishte buzëqeshjen si shkëlqim dielli, u ther me thikë para syve të mi, në dyzet e shtatë vende. Ishte natë. Ishte errësirë. S'ishte askush. Por, nuk ishte heshtje. Bërtiti nëna ime. Qau vëllai im. Ende ishte foshnjë, vetëm një vjet e gjysmë. I ishin zmadhuar sytë nga frika. Bërtita edhe unë. Sipër sokakut, shtëpive, çative, stacionit policor, gurëve të kalldrëmeve jehoi vaji im.

A nuk e keni dëgjuar? Duhet të mos e keni dëgjuar, pasi nuk keni ardhur, asnjëri nga ju. Askush nuk erdhi. As fqinjët, as xhaxhallarët policë. As politikanët që vizitonin lagjen tonë në kohë të zgjedhjeve, as gazetarët që shkruajnë nga larg, as pronarët e patundshmërive që na fusin çmime si të duan shtëpive të stërprishura. Askush nuk ishte. Thonë që Stambolli është më shumë se 10 milionë banorë. Ashtu i madh. Si mund të jetë kaq i vetmuar, i braktisur si shkretëtirë një qytet që është kaq i banuar me njerëz në çdo hap? S'mund t'i bie në fije. Që nga orët e para të mëngjesit nëna ime po hante dajak. Në praninë tonë, babai e kapi për flokësh dhe ia përplasi kokën për tavoline. Për habi, doli një zë i trashë. Thua se u ça toka. U ça dhe hyra në të, nga turpi dhe nga dhimbja

ime. Zemra mu në mes m'u thye. Një pikë gjaku rrodhi nga balli i nënës. Garnitura e bardhë sipër tavolinës u përlye. Mendja më ngeci aty për një çast. Si do ta heqë atë njollë nëna? Do të mendohej përsëri me sapun, detergjent, me ujëra të vakëta, duar e gishta të plasaritura. Në fustan e çorape, nëna ime vetë i pastronte njollat e gjakut të vet. Unë u struka në një qoshe. Kafshova gjuhën. M'u bllokua gjuha. Babai e shkëlmoi nënën, i mëshoi në bark e në shpinë. Në bark kishte shpirt. Mbante vëllanë a motrën tonë. Po të ishte vajzë emrin do ta kishte Gylizar, po të ishte djalë emrin do ta kishte Jusuf. Babai më pas nxori shkopin. Shkopin të cilin e kishte sjellë në shtëpi për të na vënë në rend neve. Kur lazdroheshim na mëshonte në shpinë. Në majë të shkopit ishte një copë lëkure e

nënës dhe flokët e saj ishin të kapura ende. Përse policët nuk e morën babanë tim? Si nuk ndërhyjnë fqinjët? Shitësi i dyqanit, kasapi, tezeti, xhaxhallarët... Ku ishin? A kaq shumë u frikësuan nga çmenduria e një njeriu të vetëm? Do të thotë, tërë qytetin një njeri i vetëm mund ta tretë?! Ashtu vallë?! Koha u errësua. Babi nuk diti të ndalej. Edhe tik-taket e orës së varur në mur u ndalën e babai jo. Ishte natë. S'ishte askush. Por, heshtje nuk ishte. Nëna rënkoi shumë derisa ra për vdekje në kolltuk. Mbeti ashtu duke mos mundur as frymë të merrte. Një ditë e pata parë një foshnje kukull të shtrirë në mbeturina. Krahun e dalë vendi, këmbët e këputura. Mu si ajo ishte nëna ime. I luhateshin duart në hapësirë.

Vëllai im qante shumë. Babi shante si mos më keq. A s'e keni dëgjuar? A aq të forta qenë muret që ju ndanë nga ne?! Më pas babai na kapi për dore dhe na tha ecni përpara. Erdhëm në stacionin policor. Vëllai im kishte urinuar në vete, këmbët i kishte pis dhe barkun e uritur. Edhe unë isha uritur, por nga frika nuk mund ta thosha. Në stacionin policor xhaxhallarët policë i thanë babait: Çfarë ke bërë? A nuk është gjynah për këta fëmijë? Kush do të kujdeset për ta tani? Vetëm atëherë e kuptova. Kuptova që nëna ime kishte vdekur. Nëna ime e bukur, që kishte buzëqeshjen si shkëlqim dielli, në të katërmbëdhjetat u bë nuse, në të nëntëmbëdhjetat u bë kurban. (Marrë nga numri i shtatë i revistës "Akademia". Përktheu: Fatijona Bajraj)

Mark Meadows, shef i ri i personelit në Shtëpinë e Bardhë

UASHINGTON, 8 MARS - Në një kohë që Shtetet e Bashkuara po përballen me situatën e krijuar si pasojë e shpërthimit të koronavirusit dhe ndërsa përgatitet për fillimin e fushatës së tij presidenciale, Trumpi ka njoftuar një ndryshim të rëndësishëm të personelit të tij në Shtëpinë e Bardhë. Ligjvënësi Mark Meadows do të jetë shefi i ri i personelit, duke zëvendësuar Mick Mulvaney i cili ka qenë shef në detyrë i personelit në Shtëpinë e Bardhë për më shumë se një vit. Presidenti e njoftoi

ndryshimin të premten në "Twitter". "E njoh prej kohësh dhe kam punuar me Markun. Marrëdhëniet tona janë shumë të mira", shkruante presidenti. "Dua të falënderoj shefin në detyrë të personelit, Mick Mulvaney, që i ka shërbyer shumë mirë administratës. Ai do të ngarkohet me detyrën e të dërguarit special të ShBA-së për Irlandën e Veriut", shkruante më tej Trumpi. Meadows njoftoi në fillim të këtij viti se do të tërhiqej nga Kongresi në fund të mandatit. Ai do të jetë shefi i katërt i personelit të Trumpit në pak më

shumë se tre vjet. Mulvaney, një ish-ligjvënës nga Karolina e Jugut, mbahet mend kryesisht për pohimin e tij gjatë një konference për shtyp se "quid pro quo" një shprehje në latinisht që nënkupton ofrimin e një favorit në këmbim të një tjetri, janë të zakonshme në politikën e jashtme. Kjo deklaratë, megjithatë, ishte në kontrast të fortë me atë që thoshte presidenti, i cili ka pohuar se nuk u përfshi kurrë në ndonjë marrëveshje të llojit "quid pro quo" me Ukrainën.



Sandersi vazhdon sulmin, Bideni paralajmëron kundër prirjeve negative në fushatë

UASHINGTON, 8 MARS - Kandidatët demokratë për garën presidenciale, Joe Biden dhe Bernie Sanders, kanë bërë fushatë të shtunën, ndërsa përgatiten për një përballje finale në Miçigan e Mizuri dhe në disa shtete të tjera. Sandersi, i cili deri para pak kohësh kryesonte garën mes demokratëve, po zvarritet për sa i takon numrit të delegatëve dhe po kërkon me dëshpërim ta rimarrë vrullin e humbur, pas një rritje të fortë të Bidenit, gjatë të ashtuquajturës "Super e marta". Bernie Sanders (78 vjeç), sulmoi Bidenin (77 vjeç) në një tubim në Miçigan të shtunën, disa orë pasi Bideni paralajmëroi kundër asaj që e quajti "gjakderdhje" apo frymë negative gjatë procesit zgjedhor në parti, duke iu referuar senatorit nga Vermonti dhe demokratit që e ka cilësuar veten socialist, ka njoftuar voa. Sandersi kritikoi ish-nënpresidentin Biden për votën e tij në mbështetje të luftës në Irak dhe për marrëveshjet tregtare që, siç tha ai, u ka kushtuar me miliona vende pune amerikanëve përfshirë edhe atyre në Miçigan. Sandersi kritikoi gjithashtu Bidenin për mbështetjen që po merr për fushatën e tij nga disa miliardërë. Senatori Sanders ngriti pyetjen nëse Bideni, siç tha ai, "mund të gjeneronte sa duhet energji e entuziazëm për t'ia dalë ndaj Donald Trumpit". Megjithatë, ai tha se Bideni është një mik i tij dhe shtoi se që të dy kishin rënë dakord të mbështetnin atë që do të fitonte garën brenda partisë. Të premten në mbrëmje, Bideni



Sandersi, i cili deri para pak kohësh kryesonte garën mes demokratëve, po zvarritet për sa i takon numrit të delegatëve dhe po kërkon me dëshpërim ta rimarrë vrullin e humbur, pas një rritje të fortë të Bidenit, gjatë të ashtuquajturës "Super e marta"

tha, gjatë një takimi fushate në Bethesda të shtetit të Marilendit. se ishte i shqetësuar pasi beteja e tij me Sandersin brenda partisë mund të merrte një drejtim të shëmtuar. Nuk mund të lejojmë që gara të shndërrohet në një "gjakderdhje", tha ai duke përdorur një metaforë për drejtimin e mundshëm negativ

që mund të marrë gara brenda partisë. "Ne nuk mund të shkatërrojmë partinë dhe të rizgjedhim Trumpin", tha ai. Gara mes demokratëve duket se është shndërruar në një garë mes dy burrash, Bidenit e Sandersit. Tulsi Gabbard, një ligjvënës e Havait, është e

vetmja kandidate grua në garë, por pa asnjë mundësi për të fituar. Bideni dhe Sandersi do të përballen nesër (e martë) në Ajdaho, Misisipi, Mizuri, në shtetin e Washingtonit, Dakotën e Veriut dhe në Miçigan. Fitorja e një numri të madh delegatësh nga ana e Bidenit në

Miçigan do t'u jepte një goditje të fortë shpresave të Sandersit për t'u bërë kandidati zyrtar i partisë. Duke shfaqur vrull të vazhdueshëm pas fitores së tij gjatë "Super të martës", zyrtarët e fushatës së Bidenit njoftuan të premten se kishte mbledhur rreth 22 milionë dollarë në pesë ditë.

Erdogani: Greqia t'i hapë portat për migrantët

ANKARA, 8 MARS - Presidenti i Turqisë, Rexhep Tajip Erdogan, i kërkoi të dielën Greqisë t'i hapte portat për migrantët, për të cilët Ankaraja njoftoi se kishte hapur kufijtë dhe t'i lejonte të

hynin në pjesën tjetër të Bashkimit Evropian. "Greqi! Po të bëj një thirrje... hapi portat dhe çlirohu nga kjo barrë", theksoi Erdogan gjatë një fjalimi televiziv. "Lejojini të shkojnë në vendet

e tjera evropiane", shtoi ai. Presidenti turk Rexhep Tajip Erdogan njoftoi se do të shkojë sot (e hënë) në Belgjikë për të diskutuar për çështjen e migrimit me zyrtarët e Bashkimit Evropian.



JO VOTEN SHQIPTARE MAQEDONIT

Sokol GASHI

Po afrohen zgjedhjet e prillit 2020 në Maqedoninë e Veriut! Sikur zgjedhjet e kaluara edhe këto zgjedhje janë me interes të gjithanshëm! Kryetari i LSDM-së Zaev u bë i pari që pas vitit 2001, arriti të merrte votë shqiptare dhe këtë fitore të parë të tijë, në zgjedhjet e prillit është duke tentuar ta thellojë edhe më shumë, ta ketë edhe me të madhe! A duhet të ndodhe në mes shqiptareve kjo? A bën të ndodhë në mes të shqiptareve kjo? Vëllezër e motra shqiptare, të përkatësisë fetare muslimane, ortodokse e shqiptare në Maqedoninë e Veriut, pashë gjakun shqiptar në deje që e keni! Pashë varret e gjyshërve e stërgjyshërve, nënave e lokeve tona heroina e të shumëvujtura! Pashë luftën shqiptare e gjakun e derdhur të luftëtarëve për liri nëpër histori e të luftës së vitit 2001 të UÇK-së në Maqedoninë e Veriut!

Pashë Dëshmorët e Heronjtë e Kombit, të plagosurit në luftë dhe invalidët e çlirimit të Atdheut! MOS JA JEP VOTEN TËNDE KANDIDATIT MAQEDON PËR DEPUTET! MOS JA JEP VOTEN TËNDE PARTISË POLITIKE MAQEDONE! Mos ja jep voten shqiptare maqedonit, se voten tënde shqiptare mundesh me ia dhënë kandidatit nga partia politike shqiptare! Ti qe e din historinë e popullit shqiptar, si mundesh me ia dhënë votën tënde kandidatit e partisë politike maqedone? A do të hahet buka e a do të pihet uji pasi ta votosh kandidatit e partinë politike maqedone? Po do të hashë e do të pishë, por do të jetosh me turp e me faqe të zezë! Ndërgjegjja nëse ke ka për të vrarë përgjithmonë! Femijët, nipërit e mbesat tuaja kur të mësojnë për këtë votën tende për maqedonin e jo shqiptarin, do të të pështyejnë mbi varr, do të turpërohen përgjithmonë! A ke harruar se çka kanë bërë

maqedonët në kohën e ish-jugosllavisë dhe pas demokracisë së viteve të 90-ta mbi popullin shqiptar në Maqedoninë e Veriut a? Të dashur dhe shumë të nderuar kryefamiljarë të familjes shqiptare në Maqedoninë e Veriut! Pashë të ardhmen e ndritur e të lumtur të fëmijëve tuaj, nipërve e mbesave, votoni kandidatët shqiptar për deputet dhe partite politike shqiptare! Qysh mundesh kur ta marrësh lapsin e votu, dhe voton për kandidatit e partinë politike maqedone, dhe aty ke kandidat shqiptar dhe parti politike shqiptare!... Votues shqiptar në Maqedoninë e Veriut, të lutem, pashë buken e pashë ujin, pashë token e pashë varret e të parëve tanë, pashë varret e dëshmorëve të Atdheut e pashë varret e veprimtareve të kombit, pashë varret mesuesve e profesoreve shqiptare, mos voto për kandidatit maqedon e për partinë politike maqedone! Nëse e ndjen veten tënde votë të mirfillët shqiptare, mos lejo të votosh për LSDM e VMRO! O vëlla shqiptar!

Oj moter shqiptare! Jo, mos voto kandidat maqedon e parti politike maqedone! Jo është mekat! Është marre! Nuk duhet dhe nuk ban që vota shqiptare të shkojë, për ata të parët e të cilëve, na kanë shtypur e na kanë mbajtur robër të tyre, për ata që në vitin 2001 të luftës çlirimtare, ishin kundër çdo gjëje shqiptare! Jo votën shqiptare për maqedonët, se të mallkon toka e të mallkon lokja, të mallkon gjaku e të mallkon Kombi, të mallkon Skënderbeu e të mallkon Atdheu! Popull shqiptar i Maqedonisë së Veriut, voto për kandidat shqiptar e për parti politike shqiptare! Popull shqiptar i Maqedonisë së Veriut, voto shqip e për parti politike shqipe! Shqiptarët e Maqedonisë, voten vetëm partive shqiptare, askujt tjetër! Vota e shqiptarit në Maqedoninë e Veriut, të shkojë për popullin shqiptar! Kush voton për kandidatit shqiptar e për partinë politike shqiptare në Maqedoni, ka

votuar jo vetëm për veten e tij, për fëmijët e tij, për nipër e për mbesa, por ka votuar edhe për SHBA, edhe për NATO, edhe për BE, edhe ka votuar për të ardhmen e lirë e origjinale shqiptare! Voto shqip e shqiptarisht, e jo maqedonisht! Shqiptarë nëse votoni shqip, do te vazhdoni të keni Kryetar shqiptar të Parlamentit, Zv. Kryeministra, shumë Ministra e zv. Ministra, Drejtorë e Zv. Drejtorë, në të kundërtën shqiptarët do bëhn të mjerë, e do të humbin fuqinë politike dhe ekzekutive ne Maqedoninë e Veriut! Jo maqedonisht, por shqip voto! Shqip për flamur e për gjuhën shqipe, për integrim euroatlantik e për emancipim njerëzor! E ardhmja e Maqedonisë së Veriut, është 50% shqiptare! Me votën tonë duhet ta rrisim këtë përqindje! Rroftë populli shqiptar në Maqedoninë e Veriut!

8 Mars 2020!





ORIANA FALLACI

LETER E ORIANA FALLACIT PËR PIER PAOLO PASOLININ

Kjo letër e Oriana Fallacit na ndihmon të njohemi më mirë me shkrimtarin e madh italian Pier Paolo Pasolini. Letra i ishte drejtuar poetit pas vdekjes dhe brenda saj Fallaci ngjall fjalë, mendime dhe emocione që poeti i kishte lënë asaj në disa letra. Pra, kjo letër është një dokument i çmuar që na jep një portret të vërtetë të autorit

“Diku, Pier Paolo, përzier me letra, gazeta dhe shënime, duhet ta kem letrën që më shkrove një muaj më parë. Atë letër mizore, të pamëshirshme, që më goditi me të njëjtën dhunë me të cilën të vranë. E barta me vete, për dytri javë rresht, në gjysmën e botës, deri në Nju Jork, pastaj e vendosa, nuk e di se ku dhe po e pyes veten nëse një ditë do ta gjej përsëri. Shpresoj jo. Po ta shikoj dhe lexoj edhe një herë do të më lëndojë po aq sa atëherë kur e lexova dhe u mërzita duke i fiksuar fjalët, me shpresë që t'i harroja. Por, ja që s'i harrova. Mund t'i rindërtoj përmendsh pothuajse. Pak a shumë kështu:

“E mora librin tënd të fundit. Të urrej që e ke shkruar. Nuk shkova përtej faqes së dytë. Nuk dua ta lexoj kurrë. Nuk dua të di se çfarë ka barku i një gruaje. Më neverit mëmësia. Më fal, por unë atë neveri e bart me vete që kur isha fëmijë, kur isha tri vjeç, më duket ose, ndoshta, ishin gjashtë kur dëgjova nënën time të pëshpëriste se...”

Nuk t'u përgjigja. Çfarë ti përgjigjesh një burri që vajton

dëshpërimin e tij pse është burrë, dhimbjen e tij pse ka lindur nga barku i një gruaje? Nuk ishte letër e drejtpërdrejtë për mua, në fund të fundit, por për veten tende, për vdekjen që gjithmonë të ndiqte për t'i dhënë fund zemërimit të të ardhurit në këtë botë falë një barku të fryrë, dy këmbëve të hapura, një kordoni këthizor të zgjidhur në gjak. Si mund të ngushëlloj të pajtohesh me një pashmangshmëri të tillë? Fjalët që të ngushëllonin ishin në librin që e refuzove me zemërim. E vetmja mënyrë për të të qetësuar do të të kishe qenë të të merrja në krahavor: të të doja sikur vetëm një grua që di ta duaj një burrë. Por ti kurrë s'e lejove një grua të të marrë në krahavor, që të dojë. Ai barku ynë nga i cili ke dalë, të ka mbushur gjithnjë me tmerr. Me përjashtim të nënës tënde e cila u nderua si një Mari e mbetur shtatzënë nga Fryma e Shenjtë, duke harruar që edhe ti ishe i lidhur me një kordon këthizor që zgjidhej në gjak. Ne gratë të kemi nxitur fizikisht një neveri.

Kur na pranoje e bëje nga keqardhja. Nëse na falje ishte për vullnet. Në çdo rast nuk harroje asnjëherë legjendën që na fajëson që kemi këputur mollën, zbuluar mëkatën. E urreje shume mëkatën, seksin, që për ty ishte mëkat. E doje shumë pastërtinë, dëlirësinë që për ty ishte shpëtimi. Dhe sa më pak pastërti gjeje, aq më shumë hakmerreshe duke kërkuar ndyrësi, vuajtje, vulgaritet: si ndëshkim. Si disa priftërinj që marrin kamxhik, e kërkoje atë me seks, që ishte mëkat për ty. Seksi urrejtës i djemve me fytyra të paqarta (ti që kishe kultin e inteligjencës), me trupin pa asnjë hir (ti që kishe kultin e hirit), nga mendja pa bukuri (ti që kishe kultin e bukurisë).

Në ato u zhyteshe, e poshtëroje veten, e humbje veten; sa më të vrullshme të ishin, më famëkeqe ishin. Për ato këndoje në poezitë e tua të bukura, librat e tu të bukur, filmat e tu të bukur. Nga ato ëndërroje të vriteshe, herët a vonë, për ta përmbushur vetëvrasjen tënde. A jam e keqe ti them këto? A jam mizore edhe unë? Ndoshta, por ishe ti ai që më mësove se duhet të jemi të singertë edhe me koston e paraqitjes si të këqij, të singertë, me koston e të qenit mizor dhe, gjithmonë, të guximshëm të themi atë që besojmë; edhe nëse është e pakëndshme, skandaloze, e rrezikshme. Ti ne shkrime fyeje, duke plagosur

deri në pikën ku thyhet zemra. Dhe unë nuk të fyej duke të thënë se nuk ishte ai shtatëmbëdhjetëvjeçari që të vrau; ti je ai që ke bërë vetëvrasje duke e përdorur atë. Nuk të lëndoj kur them se gjithherë e dija që ti po e thërrisje vdekjen sikur të tjerët që thërrisnin Zotin, që dëshiroje vrasësin si të tjerët që dëshironin parajsën. Ishe aq fetar ti që prezantoheshe si ateist. Kishe njëfarë nevojë për absoluten ti që na fiksoje me fjalën njerëzim. Vetëm duke përfunduar me kokë të thyer dhe trup të shqyer ti mund ta shuaje ankthin dhe ta kënaqje etjen tënde për liri. Dhe nuk është e vërtetë që e urreje dhunën. Me tru e dënoje, por me shpirt e kërkoje, si mënyrë të vetme për të kënaqur dhe ndëshkuar djallin që digjej brenda teje. Nuk është e vërtetë që mallkoje dhimbjen.

Përkundrazi, të shërbente si një brisk për ta nxjerrë engjëllin që ishte në ty. E vura re nga takimi i parë kur u takuam në Nju-Jork: tani, dhjetë vjet më parë. Dhe ky fakt më bëri përshtypje më shumë sesa gjeniu yt ngazëllyes, kultura jote irrituese, fantazia jote e ndezur. Vrapoje çdo natë në lagjet ku as policët nuk guxojnë të hyjnë të armatosur. Asnjëherë nuk u lodhe së sfiduari turbullirën, së prekuri tmerrin, së bashkuari me rrënojat mashkullore të varësve të drogës, të përmbysurve, të dehurve.

Pavarësisht nëse shkoje në Bowery o Harlem ose në port, gjithmonë ishe i pranishëm atje ku kishte të keqe dhe rrezik. Arthur Rimbaud, në krahasim me ty, bëhej edukator. Sa herë kam pasur frikë se mos po më thonë që të kanë gjetur me fyt të prerë apo me ndonjë plumb në zemër. Një mbrëmje edhe ta thashë. Ishim para Qendrës Lincoln dhe po kërkoje një taksì për të shkuar në një vend që nuk doje ta pranoje. Nga padurimi dukeshë i shqetësuar, dridheshe. Pëshpërita: “Do ta presin fytyrën, Pier Paolo”. E ti më vështrove me sy të ndritshëm dhe të trishtuar (sytë e tu ishin gjithnjë të trishtuar, madje edhe kur qeshje), pastaj u përgjigje me ironi: “Po?”. Te kujtohen, vërtet, ato ditë në Nju-Jork? Vije në banesën time, uleshe në divanin e vjetër, kërkoje një Coca-Cola (kurrë nuk të pashë të dehur) dhe më thoshe që e doje Nju-Jorkun sepse ishte i ndotur, pa shpirt. Në atë qytet të jashtëzakonshëm shikoje vetëm mjerimin moral, si një ish-koloni thoshe, si një nënklasë, e një varfëri që e krahasoj me varfërinë e Kalkutës, Casablancës, Bombay.

Një pasdite më the: “Më vjen keq që nuk erdha këtu më parë, 20 ose 30 vjet më parë, për të qëndruar. Nuk më kishte ndodhur kurrë që të bie kaq në dashuri me një vend. Përveç në Afrikë, ndoshta! Por në Afrikë do të doja të shkoja dhe të qëndroja

në mënyrë që të mos vritem. Po, Afrika është sikurse një drogë që merr kundër vetëvrasjes. Nju-Jorku, përkundrazi, është një luftë në të cilën ballafaqon vetëvrasjen”. Kishe ardhur nga Montreali me tren. Kishe zbritur në një stacion nëntokësor dhe nuk kishe gjetur një transportues. Me valixhet që t’i shtypnin krahët kishe kapërcyer një tunel dhe, në fund të tunelit, kishte parë një dritë verbuese. Qyteti të kishte sulmuar me lavdinë e një shfaqjeje: Jerusalemi që shfaqet në sytë e një kryqëzori, thoshe. Ndërsa rrokaqiejt i shihje si Dolomitët, e unë të dëgjoja kapluar nga frika: ishe vetëm poet apo edhe i çmendur? Asnjëherë nuk kam menduar që Nju Jorku mund të shihet si Jerusalem dhe rrokaqiejt si Dolomitët. Por në majë të atyre rrokaqiejve nuk deshe të ngjiteshe asnjëherë. Sa herë u përpoqa t’ju çoj në katin e fundit të Empire State Building! Të premtoja: “Është si të ngjitësh në një majë malore, era është e pastër atje”. Gjithmonë gjeje një justifikim: ty nuk të interesonte era e pastër. Të interesonte krenaria e Rrugës Dyzet e dy, me dritat e saj të kuqe nga ferri dhe dyqanet që shisnin pornografi.

“Dje, në rrugën Dyzet e dy, pashë një njeri që po vdiste. Në duar kishte një pako. E fiksoi dhe pastaj e përplasi për tokë me aq zemërim saqë paketa u prish. Pastaj ai njeri u mbështet për muri, rrëshqiti ngadalë në tokë dhe qëndroi aty: të vdiste. Pa u ndalur askush ta shikojë, ta ndihmojë. As unë. A është kjo e keqe? A është mungesë e keqardhjes? Ndoshta është një formë superiore e mëshirës. E kupton, me i lënë të tjerët të vdesin”.

Ne menjëherë u bëmë miq, ne miqtë e pamundur. Dmth., unë gruaja normale dhe ti burri anormal, të paktën sipas kanoneve hipokrite të të ashtuquajturit civilizim. Unë jam e dashuruar me jetën dhe ti i dashuruar me vdekjen. Unë kaq e repretë dhe ti kaq i ëmbël. Kishte një ëmbëlsi femërore tek ti, një mirësi femërore. Edhe zëri yt si të tjerët kishte një diçka femërore dhe kjo ishte e çuditshme sepse tiparet tua ishin tiparet e një burri: të thatë, të egër. Po, kishte një egërsi të fshehur në mollëzat e tua të forta, në hundën tënde si të bokserit, në buzët tua të holla, një egërsi e paligjshme. Dhe ajo transmetohej në trupin tënd të vogël dhe të hollë, në tiparet tua mashkullore, të mbytura, nga një kafshë që kërcen dhe kafshon. Por, kur flisje, buzëqeshje apo lëvizje duart, bëheshe po aq i butë si një grua, i mirë si një grua. Dhe unë ndihesha gati në siklet që provoja atë transport misterioz për ty. Mendoja, në fund të fundit, është njësoj si ndjenja e tërhequr nga një grua. Si dy gra, jo një burrë dhe një grua, shkonim për të blerë pantallona për Ninetto, xhaketa për Ninetto, dhe ti flisje për të sikur të ishte djali yt: i lindur nga barku yt, dhe jo i mbjellë nga fara jote. Sikur të

ishe xheloz për amësinë kur qortoje nënën tënde. Për Ninetto, në një dyqan në fshat, u dashuruar në një këmishë që ishte kopja e saktë e këmishëve të përdorura nga Sing Sing. Në xhepin e majtë shkruhej: “Burgu i Shtetit. Galeotto numër 3678”. E provove duke përsërit vazhdimisht: “E lezetshme, do ta pëlqejë”. Pastaj dolëm jashtë dhe në rrugë pati një procesion në favor të luftës në Vietnam, të kujtohet? Tipa të moshës së mesme ngriteshin shenja mbi të cilat shkruhej “Bombardoni Hanoi”, u ndjeve keq. Për një javë ke qenë në ankth duke më shpjeguar se momenti i vërtetë revolucionar nuk ishte në Kinë apo në Rusi, por në Amerikë. “Shko në Moskë, shko në Pragë, shko në Budapest dhe mendon se atje revolucioni ka dështuar: socializmi ka vënë një klasë në pushtet dhe punëtori nuk është mjeshtër i fatit të tij.

Shko në Francë, në Itali dhe e kupton që komunisti evropian është një njeri bosh. Vjen në Amerikë dhe zbulon të majtën më të bukur që mund të zbulojë një marksist si unë. Revolucionarët këtu sjellin në mend të krishterët e parë, në ata ekziston i njëjti absolutet i Krishtit. Më erdhi një ide: transferimi i filmit tim për Shën Paolon në Amerikë”.

Nga kultura amerikane zgjidhje pothuajse gjithçka, por sa vuajte kur dy studentet amerikane të pyetën se cili ishte poeti yt i preferuar, e ti iu përgjigje, natyrisht Rimbaud, dhe ato të dyja injoruan se kush ishte Rimbaud. Është kjo arsyeja pse u largove nga Nju-Jorku kaq i pakënaqur? Unë do të thosha jo. Unë do të thosha që e le Nju-Jorkun i zhgënjyer, sepse nuk kishe vdekur, sepse shikove jashtë shkurajimit dhe nuk u përmyse. Netët e kaluara në kërkim të vetëvrasjes ti kishin bërë vetëm mollëzat e faqeve më të egra, shikimin më të etshëm. Po ndihem, thoshe, si një fëmijë, të cilit ia kanë ofruar një tortë dhe më pas ia kanë marrë, ndërsa ishte gati ta kafshonte. Po, do të duhej të pinit një mijë hidhërime të tjera përpara se të gjenit diçë që do t’jua jepte dhuratën e vrasjes, t’jua dhurojë një vdekje koherente pas një jete koherente. Thonë që ti ishe i aftë të ishe gazmor, zë lart dhe se për këtë iu pëlqeu shoqëria me të rinj: të luaje futboll, për shembull, me djemtë e fshatrave. Por unë kurrë nuk të kam parë kështu. Melankolinë e bartje sipër si një parfum dhe tragjedia ishte situata e vetme njerëzore që ti me të vërtetë e kuptoje. Nëse një person nuk ishte i lumtur, nuk ju interesonte. Kujtoj me çfarë dashurie, një ditë, u përkulët para meje, ma shtrënguat kyçin e dorës dhe pëshpëritët: “As ti, sa i përket dëshpërimit, s’bën shaka!”

Ndoshta kjo është arsyeja pse fati bëri që të takohemi përsëri, vite më vonë. Ishte në Rio de Janeiro, ku kishit ardhur me Maria Callas për pushime. Gazetat shkruanin se ishit të

dashuruar. Ishit? Unë e di që ti dy herë në jetë ke provuar të duash një grua dhe je zhgënjyer. Por nuk mendoj se njëra nga këto dy gra ishte Maria. Ishit shumë të ndryshëm, tepër të ndryshëm estetikisht, psikologjikisht dhe kulturalisht. Në të njëjtën kohë, megjithatë, dukeshit aq të bashkuar nga një bashkëpunim misterioz. Dyshimi im është se ti e kishe adoptuar atë si motër, për ta bërë ta harrojë braktisjen e Aristoteles Onassis. Nuk u shkëpusje asnjëherë prej saj, madje e ndihmoje të vishej dhe zhvishej. Në plazh ia lyeje supet në mënyrë që dielli të mos e skuqte. Në restorante vuaje çdo teke të saj. Gjithmonë indulgjent, i durueshëm, i qetë si infermier në Lambaréné (qyteti i Gabonit, ku Albert Schweitzer themeloi spitalin e vet). Po, ne ty ishte heroizmi i misionarit që shkon për t’i shëruar lebronjtë, mirësia e shenjtorit që vuan martirizimin me gëzim. Një mbrëmje biseduam për të, në detin e Copacabanas, brenda një muzgu të trëndafiltë në të artë. Maria përgjumej mbi rërë, e mbështjellë me një kostum banjash të zi, unë të tregoja për torturat me të cilat brazilianët ushqenin të burgosurit politikë: il pau de arara, elektroskok. Më dëgjoje pa vullnet, pothuajse i irrituar me një bisedë të tillë në një muzg trëndafili në të artë. As nuk më përgjigjeshe. Vetëm kur e kuptove që më lëndove, dhe kur unë t’u vërsula duke të thënë se atëherë ti nuk ishe i singertë në protestat dhe betejat tua, që ishe thjesht një Narcis që pretendon të luftojë kundër padrejtësisë për ta përmbushur kotësinë tënde, filluat të flisnit për Jezu Krishtin dhe Shën Françeskun. Asnjë prift nuk më ka folur asnjëherë si ti për Jezu Krishtin dhe Shën Françeskun. Njëherë e di që më ke pas folur edhe për Shën Agustinin, për mëkatin dhe shpëtimin ashtu siç i shihte Shën Agustini. Ishte kjo kur më recitove përmendsh paragrafin në të cilin Shën Agustini tregon për nënën e vet kur dehej. Në atë rast kuptova që po kërkoje mëkatin për ta gjetur shpëtimin, sigurisht se shpëtimi mund të vijë vetëm nga mëkati dhe sa më i madh është mëkati, aq më çlirimtar është shpëtimi. Ajo që më thoshe për Jezusin dhe për Shën Françeskun, kur Maria përgjumej para detit të Copacabanas, më ka mbetur si një nishan. Sepse ishte një himn për dashurinë kënduar nga një njeri që nuk beson në jetë. Jo rastësisht e kam përdorur në librin që s’deshe ta lexoje.

E futa në gojën e fëmijës kur ai ndërhyr në gjyqin kundër nënës së vet: “Nuk është e vërtetë që ti nuk beson në dashuri, nënë. Beson aq shumë saqë ngulfatesh sepse e sheh kaq pak atë dhe sepse ajo që sheh nuk është kurrë e përsosur. Ti je e bërë nga dashuria. Por a mjafton të besosh në dashuri nëse nuk beson në jetë?” Edhe ti ishe i bërë nga dashuria. Virtyti yt më spontan ishte bujaria. Asnjëherë nuk dije të thoshe jo. Dhuroje

me duar plot cilido që të kërkonte, pavarësisht nëse kishte të bënte me para, punë apo miqësi. Alekos Panagulis, për shembull, i dhuroat parathënien për dy librat e tij me poezi. Dhe, varg për varg, me tekstin grek ngjitur, doje të kontrolloje se a janë përkthyer mirë. Takoheshim për këtë, e mban mend? Dhe pastaj filluam të shiheshim përsëri kur ai u lirua nga burgu dhe erdhi për të emigruar në Itali. Shkonim shpesh në darkë, të tre. Ngrënia me ty ishte gjithmonë një festë, sepse me ngrenë me ty kurrë nuk ishte e mërzitshme. Një mbrëmje, në atë restorantin që të pëlqente shkak i mocarelave, erdhi edhe Ninetto. Të thërriste “baba”. Dhe ti e trajtoje ashtu si një baba që trajton djalin e tij, të lindur nga barku i tij dhe jo nga fara e tij. Të largoheshim nga ti pas darke, nga ana tjetër, ishte një mundim. Sepse ne e dinim se ku do të shkoje çdoherë. Dhe, çdoherë ishte sikur të shikonim të vrapoje drejt një takimi me vdekjen.

Çdoherë doja t’ju kapja për xhakete, t’ju mbaja, t’ju lutja, ta përsërisja atë që ju pata thënë në Nju-Jork: “Do të bësh që ta presin fytin, Pier Paolo!” Doja të bërtisja se nuk kishe të drejtë sepse jeta jote nuk të përkiste ty dhe mjaft, për etjen tënde, për shpëtim dhe mjaft. Letërnjoftimi në skelën Pier Paolo 32 na përkiste të gjithëve. Dhe na duhej. Askush tjetër në Itali nuk mund të zbulonte të vërtetën sikurse e zbulojë ti, të aftë të na bëjë të mendojmë se si na bënte të mendojmë, të na edukonte në ndërgjegjen civile siç na edukoje ti. Dhe unë të urreja kur largoheshe me atë makinën me të cilën të tre bandat kishin për ta shtypur zemrën. Të mallkoja. Por pastaj urrejtja shtynte në një admirim të çmendur dhe unë bërtisja: “Çfarë burri trim!” Nuk flas për guximin tënd moral tani, domethënë për atë që ju bëri të shkruani në këmbim të fyerjeve, keqkuptimeve, moskuptimeve, hakmarrjeve. Unë po flas për guximin tënd fizik. Duhet për të pasur mëlçi goxha të madhe për ta frekuentuar baltën që frekuentoje ti, natën. Mëlçi të krishterëve të fyer e tallur që hyjnë në Kolosseum për t’u shqyer nga luanët. Njëzet e katër orë para se t’ju shqyejnë, unë erdha në Romë me Panagulis. Erdha e vendosur të të shoh ty, të përgjigjem me gojë për atë që më kishe shkruar. Ishte një e premtë. Dhe Panagulis të telefonojë në shtëpi, por në shifrën e tretë u fut një zë që shënoi: “Vëmendje. Për shkak të sabotimit që ka ndodhur ditët e fundit në termocentralin Eur, shërbimi i numrave që fillojnë me 59 është pezulluar përkohësisht”. Të nesërmen ndodhi e njëjta gjë. Na erdhi keq sepse ne menduam që po vinim në darkë për ty të shtunën në mbrëmje, por e ngushëlluam veten duke menduar se mund të të shihnim të dielën në mëngjes. Për të dielën patëm një takim me Giancarlo Pajetta dhe Miriam Mafai në Sheshin Navona.

Morëm nga një pije dhe pastaj shkuam për të ngrënë. Ashtu rreth orës dhjetë të telefonuam përsëri. Por, përsëri u fut ai zëri që skanoi: vëmendje, për shkak të sabotimit numri nuk funksionon. Te sheshi Navona shkuam pa ty. Ishte një ditë e bukur, një ditë plot diell.

Në kafeterinë “Tre Scalini” filluam të flasim për Frankon (Françisko Franko, diktatorin spanjoll), i cili nuk vdes kurrë, dhe unë mendoja: do të më pëlqente të dëgjoja Pier Paolo të fliste për Frankon që nuk vdes kurrë. Pastaj na u afrua një i ri që shiste gazetën dhe i tha Pajettes: “E kanë vrarë Pasolinin”. E tha me një buzëqeshje, sikur duke njoftuar humbjen e një skuadre futbollit. Pajetta nuk e kuptoi. Apo nuk donte ta kuptonte? Ajo ngriti ballin egër e belbëzoj: “Kush? Kanë vrarë kënd?” E djali sërish tha: “Pasolinin”. Dhe unë, në mënyrë absurde: “Cilin Pasolin?” Djali: “Qysh cilin?! Qysh cilin Pasolin?! Pasolini, Pier Paolo”. Dhe Panagulis tha: “Nuk është e vërtetë”. Dhe Miriam Mafai tha: “Kjo është një shaka”. Por në të njëjtën kohë ajo u ngrit dhe vrapoi për të telefonuar e për të pyetur nëse ishte shaka. Ajo u kthye pothuajse menjëherë me një fytyrë të zbehtë. “E vërtetë. E kanë vrarë me të vërtetë”. Në mes të sheshit një shakaxhi me pantallona jeshile luante një tub të gjatë. Duke luajtur kërcente duke ngritur në mënyrë groteske këmbët e mbështjella me pantallonat jeshile e njerëzit qeshnin. “E vranë në Ostia, këtë nate”, shtoi Miriam. Dikush qeshi me zë të lartë sepse shakaxhiu tundi tubin e tij dhe këndoi një këngë absurde. Këndonte: “Dashuria ka vdekur, presje, dashuria ka vdekur, pikë! Prandaj unë ju qaj, presje, prandaj unë ju qaj, pikë!” Ne nuk shkuam për të ngrënë. Pajetta dhe Mafai u larguan me kokat ulur, unë dhe Panagulis filluam të ecim pa e ditur se ku.

Në një rrugë të shkretë ishte një bar i shkretë, me televizion ndezur. Hymë duke na ndjekur një riosh i cili pyeste i trembur: “A është e vërtetë? A është e vërtetë?” Dhe pronarja e barit pyet: “E vërtetë çka?” Dhe rioshi përgjigjet: “Për Pasolinin. Pasolini i vrarë”. Dhe pronarja e barit bërtet: “Pasolini Pier Paolo? Jezus! Jezus-Maria! I vrarë! Jezus! Duhet të jetë çështje politike!” Pastaj në ekranin e televizionit u shfaq Giuseppe Vannucchi (gazetar i lajmeve “Rai”) dhe dha lajmin zyrtar. Dy njerëz të rëndomtë që kishin zbuluar trupin tënd u shfaqën, gjithashtu. Ata thanë se nga distanca nuk dukeshë as si një trup, ishe shumë i masakruar. Dukeshe si një grumbull plehrash dhe vetëm pasi ata shikuan nga afër, vunë re se nuk ishin plehra, por se ishe një njeri. A do të më keqtrajtosh ende nëse them se nuk ishe një njeri, por ti ishe një dritë dhe një dritë është shuar?”

*Romë, 16 nëntor 1975
(Marrë nga numri i shtatë i revistës “Akademia”).
Përktheu: Leonora Buçinca)*

Historia e panjohur e shqiptarëve në Turqinë e viteve 1912–1923

Historia e panjohur e shqiptarëve në Turqi dhe fundi i Perandorisë Osmane, 1912–1923, i studiuesit amerikan Ryan Gingeras, përkthyer nga Virgjil Muçi, Botimet IDK

Flitet shumë për shqiptarët e Turqisë, por, në të vërtetë, për historinë e atyre dhjetëra mijëra syresh që emigruan në Anadoll mes viteve 1912-1923 dimë fare pak: Ç'ndodhi me ta pasi u vendosën në Anadoll? Pse autoritetet turke i shihnin me aq dyshim, duke mos i lejuar të vendoseshin në qytetet kryesore apo në zonat e konsideruara sensitive? Cila ishte qëndresa e tyre ndaj politikës së shpallur "për të shkukur me rrënjë gjuhën dhe zakonet e tyre", që të ktheheshin në qytetarë besnikë turq? Bazuar kryesisht në hulumtimet e kryera në arkivat turq, studiuesi amerikan Ryan Gingeras na sjell një vepër mjaft të rëndësishme për këtë pjesë thuajse të panjohur të historisë. "Narrativa nacionaliste e historisë së Shqipërisë shmang enkas një nënndarje të rëndësishme të popullsisë: ata që thjesht hoqën dorë krejtësisht prej nacionalizmit shqiptar. Ky segment i kombit "imagjinari" shqiptar përfaqësohej në mënyrë të veçantë nga një numër i madh individësh që emigruan jashtë viseve shqipfolëse të Ballkanit Jugor dhe shkuan u vendosën gjetiu". "Ndonëse në dukje nuk përbënin të njëjtin nivel kërcënimi vdekjeprurës për sigurinë e shtetit, si grekët dhe armenët, që në nenin e parë të talimname të vitit 1917 nënvizohej mosbesimi i përgjithshëm që ekzistonte ndaj shqiptarëve mbas krijimit të një shteti të pavarur shqiptar".

Ryan Gingeras, aktualisht profesor në Departamentin e Çështjeve të Sigurisë Kombëtare në Naval Postgraduate School, SHBA, konsiderohet një ndër njohësit më të mirë të historisë së Turqisë, Ballkanit dhe Lindjes së Mesme. Autor i katër librave, ku mund të përmendim "Rënia e Sulltanatit: Lufta e Madhe dhe fundi i Perandorisë Osmane" (2014) dhe "Heroina, krimi i organizuar dhe bërja e Turqisë moderne" (2015). Libri i tij "Brigje të pikëlluara" ka marrë çmimet "Rothschild Book Prize in Nationalism and Ethnic Studies" dhe "British-

Kuwait Friendship Society Book Prize". Më poshtë botojmë parathënien e autorit Gingeras:

Në qoftë se gjërat do të thuheshin troç, ky punim doli në dritë falë një akti b u r r a c a k ë r i e . Ambiciet e mia, të cilat shkonin përtej provimeve, ishin të prirura për kah njëfarë projekti radikal, sfidues. Pothuajse e kisha mbledhur mendjen që disertacionin do ta shkruaja rreth ndonjë cepi të Anadollit gjatë Luftës së Parë Botërore dhe/ose fillesave të Republikës Turke. Duke rrahur ta kap demin për brirësh, mora për nga Anadoli Lindor. Sakaq, m'u ndërmendën nja dy ide: ndoshta një studim se si qyteti i vogël i Naxçivan-it u bë pjesë e Azerbajxhanit; ca më mirë akoma, rindërtimi i Kars-it si rrjedhojë e krijimit të Republikës Turke. Të dyja tok, thashë me vete, hyjnë në punë që ç'ke me të. Por ja që miq e kolegë me një barrë përvojë në studimet osmane më paralajmëruan e më thanë se, në thelb, nuk po bëja gjë tjetër veçse do t'ia hiqja vetes profesionalisht. Pikësëpari, ishte çështja e burimeve. Ku do t'i gjeja? A ekzistojnë vallë asi dokumentesh? Dhe çka ishte më e rëndësishmja, a do të më lejonin arkivistët turq të shihja dokumentet (një pyetje kjo që pasohet nga histori anekdotike tmerresh rreth studiuesve që u mohohet hyrja në arkivat shtetërore në Turqi)?

Paskëtajin vinin pasojat politike që duheshin pasur parasysh. Një disertacion që kishte të bënte me kurdët, armenët dhe subjekte të tjera që konsideroheshin tabu në Turqi, veçse do të më hapte telashe. Pavarësisht se çfarë

kisha për të nxjerrë nga duart, më thanë, dikujt kishte për t'i mbetur hatri prej punës sime. Dikush tjetër, qoftë ai ndonjë ministër turk, pjesëtar i diasporës armene ose ndonjë studiues osman, kishte për të më ngrënë me gjithë lecka, duke qenë se kisha sfiduar, mbështetur ose shpërfillur një sërë aspektesh të historisë së kohëve të fundit të Anadollit Lindor. Me pak fjalë, këshilla që më dhanë ishte kjo: mos e bëj. Mos e vrit karrierën tënde, pa filluar mirë. Përfundimisht, disertacioni që shkrova u ngrit mbi këtë këshillë. Koha e kaluar

e qark. Mjaft të zija ngoje dhe të shprehja interesin tim lidhur me emigrantët myslimanë në Anadoll dhe kjo gjë përshëndetej me një entuziazëm të çiltër e gjente mbështetje sakaq nga arkivistët, të cilët ndihmuan që hulumtimi im të bëhej i mundur. Sidoqoftë, rrallëherë e preka temën e armenëve dhe të grekëve me punonjësit e arkivave. Duke qenë se nuk përbënte diçka qendrore ku qe fokusuar punimi im, fati paralel i jomyslimanëve në Anadollin Perëndimor gjatë viteve të luftës përbënte një subjekt që e mbaja të fshehtë. Këshillat e dikurshme gjëllinin ende në mendjen time. Kjo parathënie shërben si një apologji dhe shpjegim i tërthortë për vijueshmëritë dhe mosvijueshmëritë që vihen re midis disertacionit dhe këtij libri. Pyetja se çfarë ndodhi me grekët dhe armenët e Anadollit (por edhe me grupet e tjera të kriminalizuara) përgjatë viteve 1912-1923, vijon të peshojë edhe sot e kësaj dite si një gorillë 500-paundëshe mbyllur në një dhomë. Ngjarjet e kohëve të fundit, siç qe vrasja e Hrant Dinkut, e vërtetojnë këtë gjë. Prapëseprapë, unë jam i mendimit se persekutimit të të krishterëve osmanë nuk mund t'i qasemi

të izoluar. Për më tepër, rreth kësaj pike për mua është krejt e qartë se, përgjatë gjithë kësaj kohe, ka një histori më universale për të kallëzuar lidhur me nivelin dhe domethënien e vuajtjeve njerëzore në Anadoll. Siç do të qartësohet në faqet e vijim, modele të ngjashme të të arsyetuarit dhe të të sjellurit nga ana e qeverisë osmane, por edhe nga fuqitë pushtuese të Greqisë e vendeve të tjera, shpunë në zhvendosjen në masë, shfarosjen si të të krishterëve ashtu edhe të myslimanëve. Shkalla në të cilën bashkësi të ndryshme u viktimizuan nga trupat shtetërore që haheshin me njëra-tjetrën, doemos që ndryshon në mënyrë të papërfytyrueshme (në qoftë se do të shtrëngoheshin të bëja një krahasim, atëherë është më se e qartë se, aty nga viti 1923, armenët dhe grekët së toku zinin

një pozitë shumë herë më pak të lakmueshme sesa emigrantët myslimanë). Në qoftë se dikush merr të krahasojë nivelin e vuajtjeve, kjo nuk ka të bëjë me punën tonë. Përkundrazi, ky libër shtron pyetjen dhe merret saktësisht me faktin se përse, vallë, dhe në ç'masë grupe të mëdha njerëzish që jetonin rreth e qark brigjeve jugore të detit Marmara iu nënshtruan një sërë fushatash që synonin t'u bënin keq. Për të ndriçuar më mirë unanimitetin e vuajtjeve të zbuluara në gjirin e bashkësive të ndryshme që jetonin rreth e qark brigjeve jugore të detit Marmara, e vura theksin kryesisht mbi çështjen armene dhe atë greke. Edhe pse nuk kam kurrfarë dyshimi për këtë gjë, unë besoj se këta hapa vijnë në ndihmë për të ngushtuar hendekun historik midis të krishterëve vendas dhe myslimanëve të ardhur, madje shumë më mirë se orvatja ime e mëparshme. Ndonëse teksti që vijon nuk është këqyrur si një punim krahasues, mund të thuhet se historia e Anadollit përgjatë kësaj periudhe kohore nuk është diçka unike në kuptimin global. Diskriminimi në masë dhe likuidimi i popullsisë vendase është një fenomen që mund ta pikasësh kudo nëpër botë. Terrori shtetëror i kësaj natyre është një dukuri moderne dhe si e tillë, është pjesë përbërëse e logjikës moderne të shtetndërtimit. Duke e vendosur këtë studim brendapërbrenda një rajoni të caktuar, si dhe duke iu qasur një mase të qartë e të përcaktuar njerëzish, unë shkoj e ndërmarr disa koncepte të ngjeshura, historike dhe, siç pranohej përgjithësisht, tejet kritike: modernizimi i shtetit, dhuna e organizuar, formimi i identitetit, emigracioni dhe rrjetet e politikës. Duke e kufizuar punimin tim, si nga ana gjeografike ashtu edhe sociale, shpresoja që ta bëja më të manovrueshëm diskutimin e gjithë këtyre fijeve të larmishme historike, ndërsa narrativën sa më të padukshme. Duke hedhur sytë pas mund të them se nuk më vjen keq që shkova dhe ndoqa këshillat e kolegëve të mi të besuar. Tek e fundit, unë e ndiej se më kanë shpënë pas për të shtjelluar objektivat e mi zanafillorë. Gjithsesi, shpresoj se të tjerë njerëz (që e kanë lëkurën më të trashë se timen) kanë për t'u marrë me historitë e Kars-ës dhe të Naxçivan-it, si dhe ngjarje të tjera me peshë për t'u kallëzuar.



Operacioni ushtarak që frymëzoi filmin ‘1917’!?



A është filmi “1917”, i bazuar mbi një histori të vërtetë? Po edhe jo. Filmi dramatik me ngjarje nga Lufta e Parë Botërore, me skenar dhe regji të Sem Mendes, tregon historinë e dy ushtarëve të rinj britanikë të cilët urdhërohen nga komanda të kalojnë në “tokën e askujt” (hapësirën mes dy llogoreve armike), që të parandalojnë një sulm të planifikuar britanik, i cili kishte të ngjarë të sillte vdekjen e qindra ushtarëve. Këta dy ushtarë nuk kanë ekzistuar vërtet, madje asnjë nga ata për të cilët flitet në film. Por, teksa personazhet në film janë imagjinarë, ngjarjet e vitit 1917 u bazuan mbi një tërheqje të vërtetë strategjike që ndodhi në fakt nga ushtria gjermane, koduar me emrin “Operacioni Alberich”.

Idea për filmin “1917”, regjisorit të njohur i erdhi nga gjyshi i tij Alfred Mendes, që ishte një lajmëtar për britanikët në Frontin Perëndimor. Mendes dëshironte të nderonte kujtimin e gjyshit e të tij, por edhe të të gjithë trupave që luftuan në Luftën e Parë Botërore.

“Unë kisha një histori familjare, që ishte një fragment i treguar nga gjyshi im. Është historia e një korrieri që ka një mesazh për ta dërguar dikë. Ajo histori më intrigoj shumë që kur isha fëmijë. Padyshim, unë e kam zgjeruar dhe ndryshuar shumë atë. Gjithsesi, ajo e ka

ende thelbin e saj”, deklaroi Mendes në një intervistë për “Time”.

Mendes dëshironte që filmi të bazohej mbi ngjarjet e vërteta të Luftës së Parë Botërore, dhe të ishte sa më i saktë në aspektin historik. Kur ishte duke hulumtuar mbi skenarin e filmit, Mendes gjeti një ambient perfekt: Operacionin Alberich. Deri në vitin 1917, Fronti Perëndimor ishte shndërruar në një luftë të egër llogoresh dhe forcat gjermane mezi po rezistonin. Ato kishin kaluar nga ofensiva në mbrojtje, përballë presionit të pamëshirshëm nga trupat bri-

tanike dhe franceze, me Betejën e Verdunit dhe Betejën e Somës që dobësuan shumë gjermanët.

Erich Ludendorff, që ishte bërë kohët e fundit një nga figurat kryesore të rezistencës gjermane, bëri në fundin e vitit 1916 një panoramë të zymtë të shanseve të Gjermanisë për fitoren e luftës. Në atë kohë ai shkruante: “Gjermania duhet të mos harrojë se epërsia e madhe e armikut në njerëz dhe materiale, do të ndjehej edhe më dhimbshëm në vitin 1917. Nëse lufta do të zgjaste, humbja jonë dukej e pashmangshme. Ekonomikisht, jemi në një pozitë shumë të pafavorshme për një luftë të gjatë”.

Duke e ditur se gjermanët kishin nevojë për një strategji të re që të shmangnin humbjen e luftës, Ludendorff prezantoi Operacionin Alberich. Bëhej fjalë për një tërheqje të guximshme dhe strategjike, që do t'i lejonte trupat gjermane të riorganizoheshin dhe të krijonin një linjë mbrojtëse më të shkurtër dhe më të fortifikuar, të quajtur “Linja Hindenberg”. Dhe kjo, në një kohë kur forcat aleate do të supozonin se armiku i tyre po braktiste betejën. Në këtë mënyrë, trupat britanike do të binin pa vetëdije në një kurth, nga pozicioni i fortifikuar i krijuar nga “Alberich”. Tërheqja nisi zyrtarisht më 9 shkurt dhe përfundoi më 20 mars, duke e shkurtuar me 40 kilometra frontin gjerman dhe duke u dhënë mundësi ta mbronin atë me më pak se 14 divizione.

Por, tërheqja ishte vetëm një pjesë e operacionit. Që të siguroheshin që trupat britanike të

mos kishin qasje në burimet e lëna pas, gjermanët përdorën politikën e “tokës së djegur”. Pra, shkatërrimin e çdo gjëje që mund të rezultonte e dobishme për forcat aleate, përfshirë qytetet, rrugët dhe urat. Ndërkohë, gjermanët minuan shumë zona që britanikët të vonoheshin sa më shumë në pushtimin e zonës së braktisur tashmë nga forcat gjermane.

Operacioni “Alberich” u zbatua me sukses. Gjermanët ia dolën të zhvendosnin vijën e tyre mbrojtëse, ndërsa britanikët besuan se armiku i tyre ishte në një tërheqje të plotë. Pra, britanikët do të supozonin se po sulmonin një linjë mbrojtëse gjermane të dobësuar, por në fakt do të zbulonin se ajo ishte e riorganizuar dhe plotësisht gati për të ndërmarrë një kundërsulm.

Ky është konteksti mbi të cilin fillon filmi “1917”, kur dy ushtarët dërgohen në një mision për të paralajmëruar trupat britanike, para se të bien në kurthin e linjës mbrojtëse të sapokrijuar. Meqë britanikët besuan fillimisht se gjermanët po tërhiqeshin të dëshpëruar, ata supozuan se një sulm kundër tyre në atë moment do t'i jepte një avantazh të mëtejshëm në luftë dhe potencialisht do të çonte në një fund të shpejtë të konfliktit. Përkundrazi, ata zbuluan se gjermanët kishin krijuar një linjë të re mbrojtëse prej 128 kilometrash, e cila ishte shumë më e fortë sesa sistemi i tyre i mëparshëm mbrojtës.

Edhe pse ishte më e shkurtër, Linja Hindenburg u dha forcave gjermane disa avantazhe

strategjike të mëdha, përfshirë një terren më të lartë, gjë që ua vështirësonte trupave britanike përparimin gjatë sulmeve. Kjo vonoi ndjeshëm planet britanike në pranverën e atij viti, pasi strategjia e tyre sulmuese u ngadalësua.

Në filmin “1917”, ushtari William “Will” Schofield, arriti të njoftojë në kohë kolonelin Mackenzie që të anulonte sulmin britanik, që ishte në nisje e sipër. Në realitet, aleatët u kapën më së shumti në befasi dhe Linja e Hindenbergut e ndali vrullin e tyre. Për pasojë, rifilloi lufta e egër e llogoreve, duke zhdukur për momentin çdo shpresë për fundin e shpejtë të luftës.

Gjithsesi, Operacioni “Alberich” vërtetoi se mund të ndalte vetëm përkohësisht të pashmangshmen. Forcat aleate arritën ta çanin atë më 29 shtator 1918, falë një bombardimi masiv që zgjati mbi 50 orë, përdorimit të batalioneve të tankeve dhe një numri të madh ushtarësh amerikanë. Në atë kohë, Linja Hindenberg ishte linja e fundit mbrojtëse për gjermanët, ndaj shkatërrimi i saj e rrënoi moralin e ushtrisë gjermane.

Më 11 nëntor 1918, një armëpushim i dha fund Luftës së Parë Botërore. Mund të mos jetë e drejtë të kritikohet një komb në luftë, pse bën gjithçka që mundet për ta fituar atë. Por, po të mos ishte për suksesin e Operacionit “Alberich”, ndoshta lufta do të kishte përfunduar shumë më shpejt, dhe mijëra burra nuk do të kishin vdekur.

/Burimi: All That is Interesting/Në shqip nga: Bota.al/

E rrallë

Harron çantën në shtëpi, ia sjellin me helikopter në universitet

Një helikopter është parë duke ateruar në parkingun e një universiteti në Afrikën e Jugut. E tëra ndodhi pasi një student kishte harruar çantën në shtëpi dhe familjarët ia kishin sjellë me fluturake. Videoja

është filmuar në universitetin Vaal në Vanderbijlpark në jug të Johannesburgut gjatë të premtës së kaluar. Aty shihet se si një student afrohet në helikopter për ta marrë çantën që e kishte harruar në shtëpi.



FOTO E DITES



Me rastin e Ditës së Gruas, disa vajza myslimane në një shkollë në Indi performojnë një art ushtarak vietnamez. /AFP/

E jashtëzakonshme

Në një qytet në Itali, qytetarët janë shërbyer me verë të kuqe përmes çezmës

Kush nuk do të donte që vera e kuqe të rrjedhë nga lavamani i kuzhinës? Për disa javën që lamë pas, banorët e qytetit verior të Italisë, Castelvetro, e kuptuan se mund ta kishin verën e kuqe jo vetëm nga shishet, por edhe nga rubinetet dhe dushi i tyre. Një mosfunksionim në një kompani që prodhon verë bëri që 1 000 litra verë të gatshme në shishe të rrjedhin nga tubat te qytetarët.



BARSOLETA E DITËS



Në shkollë mësuesja po shpjegonte:
- Unë studioj, ti studion, ai ajo studion.
Çfarë kohe është Toni.
- Është kohë e humbur mësuese!



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Në ora 18:00
Spies in Disguise 3D

I Animuar/Aksion/Aventurë; 1 orë 42 min

Rolet: Will Smith, Tom Holland, Ben Mendelsohn, Karen Gillan, Rashida Jones, DJ Khaled, Masi Oka

Regjia: Troy Quane, Nick Bruno

Në ora 18:00
Jumanji; The Next Level 3D

Aksion/Aventurë/Komedi; 2 orë 03 min
Rolet: Dwayne Johnson, Jack Black, Kevin Hart, Karen Gillan, Nick Jonas, Awkwafina, Ser'Darius Blain, Madison Iseman, Morgan Turner, Alex Wolff, Danny Glover, Danny DeVito, etj.

Regjia: Jake Kasdan




Çdo natë në ora 20:00

STAR WARS; THE
RISE OF
SKYWALKER 3D

Aksion/Aventurë/Fantazi; 2 orë 21 min

Rolet: Daisy Ridley, Adam Driver, Mark Hamill, John Boyega, Oscar Isaac, etj

Regjia: J.J. Abrams



Çdo natë në ora 22:30

THE GRUDGE

Horror/Mister; 1 orë 34 min

Rolet: Sarah Michelle Gellar, Jason Behr, Kadee Strickland, Clea Duvall and Bill Pullman

Regjia: Takashi Shimizu



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe **boxoffice@kinoabc.info**, **www.kinoabc.info**, **fb: Kino ABC**.




DASHI

Disa shqetësime për shëndetin e një gjyshi, por nuk ka nevojë të emocionoheni, nën temperamentin e tij ai është më i fortë se i juaji.



DEMI

Ju do të jeni shumë aktiv dhe i vendosur, keni energji, vendosmëri dhe iniciativë për çdo gjë, prandaj, dita e zënë nuk do t'ju trembë aspak.



BINJAKËT

Nëse ka pasur një largim midis të afërmeve, ka ardhur koha për ta zgjidhur çështjen dhe mosmarrëveshjet përpara një tryeze të shtruar.



GAFORRJA

Partneri juaj do të jetë më shumë se kurrë luftues dhe xheloz. Sa për çështje praktike, ngadalë arrini atë që dëshironi.



LUANI

Do të keni pak fjalë dhe pak ide. Shpenzimet pritet të jenë të forta, madje as kërkesat për para nga vëllai juaj ose një miku nuk përjashtohen.



VIRGJËRËSHA

Marrëdhëniet shoqërore janë në rënje, por nuk është e përshtatshme për ju të mbyllni veten në shtëpi.



PESHORJA

Përfiton nga stimujt që mund të mbliidni nga një kontakt i ri, do t'ju ofrojë ide dhe mjete të dobishme për ta theksuar veten.



AKREPI

Hëna në Luan ndodhet kundër jush. Rezultati? Ju ndihen i hutuar, me moral në tokë, shihni gjithçka të zezë.



SHIGJETARI

Kalimi i Hënës në Luan, përveç rimbushjes së baterive tuaja, e kanalizon tepriçën e energjisë në veprime të shpejta.



BRICJAPI

Thirrja e së kaluarës është e fortë! Janë kujtime që nuk do ta ngrohni shumë zemrën tënde.



UJORI


Gjërat nuk shkojnë mirë si në këtë ditë. Një takim i humbur ose një ngjarje e papritur që mund t'ju çojë në befasi.



PESHQIT

Do të jeni më të hapur, dinamik dhe komunikues sesa zakonisht, dhe kjo do ta rrisë shumë vlerësimin tuaj në fushën sociale.

Rita Ora paralajmëron diçka të re



Këngëtarja shqiptare me famë botërore, Rita Ora, ka paralajmëruar se po sjell diçka të re. Rita nëpërmjet një postimi në “Instagram” i ka paralajmëruar fansat se javën e ardhshme do të vijë me një befasi për ta. “Një befasi e madhe

javën tjetër... e ardhmja duket e artë, kush i ka parë të dhënat”, ka shkruar Rita. Ky paralajmërim erdhi pas publikimit të disa fotografive nga gazeta britanike “The Sun”, imazhe në të cilat këngëtarja shqiptare shihet pranë yllit televiziv, Joey Essex.

Garfield rikthehet si Spider-Man?



Andrew Garfield vrapon shpejt gjatë xhirimit të skenës së filmit të tij të ri “Tick, Tick... Boom!” Sipas disa raportimeve,

Andrew mund të rikthehet si Spider-Man në filmin e ardhshëm “Into The Spiderverse”. Kjo mbetet të shihet.



Kate Middletoni shfaqet disa herë me të njëjtën pallto

Nuk është hera e parë që Kate Middleton shfaqet në publik me veshje të njëjtë. Mjafton të kujtoni se për dasmën e princit Harry dhe Meghan Markle u shfaq me një fustan Alexander

McQueen, të cilin e kishte veshur edhe më parë. Kjo është një praktikë e njerëzve të famshëm për ta theksuar ndikimin në mjedis që kanë gardërobat e tyre. Mirëpo një pallto që nga viti 2008 është diçka jo fort e zakonshme, shkruan “Anabel”.

Eva Mendes nuk poston kurrë foto të Ryan Gosling, por pse?

Eva Mendes bën pjesë në listën e VIP-ave që s’e kanë shumë qejf “Instagram”-in, por edhe pse e përdorë rrallë, ndërveprimi me fansat është fantastik. Në llogarinë e “Instagram”-it të aktorese ka vetëm foto të saj. Zor se Mendes poston fotografi me Ryan Gosling apo fëmijët e tyre. Një prej komentuesve mori shkas nga fotoja e postuar së fundmi për t’ia vënë në dukje një detaj të tillë. “Dukesh një mrekulli. Dua thjesht ta dish sa rëndësi ka për ne, fansat e tu të flasim me ty. Nuk do ta kishim problem edhe nëse nxjerr Ryan-in në këtë faqe”. Eva, nuk ngurroi t’i përgjigjej, duke i kujtuar edhe



nj ëherë raportin problematik që ka me rrjetet sociale. “Unë i kam pak problem rrjetet sociale, por dua që gjithë kohës të jem në kontakt me gratë. Përpiqem që çdo postim ta bëj me përgjegjësi dhe të sigurohem që të mos e portretizoj veten në një formë që mund t’i bëjë të tjerat të ndihen keq”, është përgjigjur ajo.

EURO GLASS

SAINT-GOBAIN
SEKURIT

PILKINGTON

Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com

Montim

Servisim

Reparim

QENDRA SPORTIVE

‘BUJQËSIA’

TEL: 045/82 82 82

Drita fiton derbin kundër Prishtinës, Gjilani bie në ‘Zahir Pajaziti’

Gara për titull vazhdon të bëhet edhe më interesante. Dy skuadrat pretendente, Prishtina dhe Gjilani, kanë pësuar humbje të dielën nga Drita, përkatësisht Llapi. Ballkani sot (e hënë) me fitore ndaj Flamurtarit mund ta shtojë diferencën me skuadrat përcjellëse

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 8 MARS - Dy ndeshje të javës së 22-të në IPKO Superligën e Kosovës në futboll janë zhvilluar të dielën. Fituese dolën Drita dhe Llapi në përballje me Prishtinën dhe Gjilanin. Derbi i zhvilluar në Gjilan rezultoi i pamëshirshëm për Prishtinën e cila humbi nga Drita (2-1). Duhet cekur se kryeqytetasit në këtë ndeshje u dënuan nga dy ish-sulmuesit e saj. Drita, e cila ndeshjen e fundit e kishte humbur nga Ballkani, arriti ta harrojë shpejt dhe t'i rikthehet fitores në një tjetër ndeshje derbi. Në minutën e shtatë Kastriot Rexha shënoi golin e parë, por kryeqytetasit nuk u dorëzuan dhe arritën ta barazojnë rezultatin nëpërmjet Otto John në minutën e 71-të. Gjashtë minuta më vonë skuadra gjilanasë e riktheu epërsinë me golin e shënuar nga Astrit Fazliu. Drita e rikthen pozitën e dytë në tabelë me 43 pikë, kurse Prishtina bën një hap në garën për titull pasi që dallimi me skuadrën lidere mund të shtohet deri në shtatë pikë. Skuadra e Llapit është treguar e fortë në përballje me Gjilanin,

pasi ka shënuar fitore me rezultat 2-0. Llapjanët në ndeshjen e zhvilluar në stadiumin “Zahir Pajaziti” e nisën mirë ndeshjen dhe shënuan pas dy minutave nga penalltia me anë të Arbnor Ramadanit. Gjashtë minuta pa përfunduar pjesa e parë për 2-0 u përkujdes Erlis Ymeri. Në minutën e 70 Gjilani e ngushtoi epërsinë me golin e Darko Niaqit, por kjo ishte e tëra që arriti në këtë ndeshje. Gjilani, pas kësaj humbje, bie në pozitën e tretë me 41 pikë, kurse Llapi është në pozitën e pestë me 35 pikë. Skuadra e Ferizajt ka vazhduar formën e mirë edhe të shtunën, kur e mposhti Trepçën '89 me rezultat bindës 4-0. Mesfushori me përvojë të madhe në futbollin e Kosovës, Taulant Dajaku, ka shënuar dy golat e parë për Ferizajin, kurse nga një e shtuan Edon Sadriu e Nermin Hajdareviq. Ferizaj renditet i nënti me 25 pikë, vetëm një më pak se Trepça '89 që zë pozitën e tetë.

Sot (e hënë) zhvillohen tri ndeshjet e fundit për këtë xhiro. Vëmendja kryesore do të jetë në kryeqytet, ku përballen Flamurtari dhe Ballkani. Kampioni në fuqi, Feronikeli, e pret në Drenas Vushtrrinë. Në



këtë ndeshje do të debutojë trajneri i ri i “Niklit”, Afrim Tovërlani. Ndërsa në Klinë përballen Dukagjini dhe Drenica.

Besa, sigurt drejt Superligës

Skuadra e Besës së Pejës është duke ecur sigurt drejt rikthimit në IPKO Superligë. Skuadra pejane e fitoi derbin ndaj Vëllaznimit me

rezultat 0-2 dhe pas kësaj fitore vazhdon të jetë në pozitën e parë me katër pikë më shumë se skuadra përcjellëse. Fitore të rëndësishme ka shënuar edhe Liria në përballje me Onixin nga Banja (2-0). Pas këtyre tri pikëve klubi prizrenas ngritet në pozitën e tretë dhe hynë në garë të ngushtë për rikthim në elitë. Istogu ndau pikët me 2 Korrikun (1-1), në ndeshjen që u zhvillua në stadiumin “Demush Mavraj”.

IPKO SUPERLIGA - Java 22

Drita - Prishtina 2-1
Llapi - Gjilani 2-1
Ferizaj - Trepça '89 4-0

Të hënë takohen:
14:00 Flamurtari - Ballkani
14:00 Dukagjini - Drenica
14:00 Feronikeli - Vushtrria

Tabela		PIKË
1. Ballkani	21	44
2. Drita	22	43
3. Gjilani	22	41
4. Prishtina	22	41
5. Llapi	22	34
6. Feronikeli	21	31
7. Drenica	21	27
8. Trepça '89	22	26
9. Ferizaj	22	25
10. Flamurtari	21	25
11. Vushtrria	21	16
12. Dukagjini	21	10

LIGA E PARË - Java e 20

Trepça Ramiz - Sadiku 1-1
Liria - Onix 2-0
Vëllaznimi - Besa 0-2
Ulpiana - Drenasi 0-1
Dardana - KEK-u 0-0
Arbwria - Malisheva 1-0
Istogu - 2 Korriku 1-1
Vitia - Vllaznia 2-2

Tabela		PIKË
1. Besa	20	40
2. Arbëria	20	36
3. Liria	20	31
4. Istogu	20	31
5. Drenasi	20	30
6. 2 Korriku	20	30
7. Malisheva	20	30
8. Dardana	20	30
9. Onix	20	29
10. KEK-u	20	28
11. Trepça	20	23
12. Ulpiana	20	22
13. Vllaznia (P)	20	21
14. Ramiz Sadiku	20	20
15. Vitia	20	17
16. Vëllaznimi	20	17

Prishtina mposhti Yllin, Bashkimi triumfon ndaj Feronikelit



PRISHTINË, 8 MARS - Sigal Prishtina ka shënuar fitore ndaj Golden Eagle Yllit me rezultat 93:83 (34:18, 19:21, 18:23, 22:21) në kuadër të javës së 27-të të Superligës së Kosovës në Basketball. Vendësit e nisën ndeshjen shumë më mirë, duke qenë bindshëm më të mirë në çerekun e parë, të cilin e fituan 34:18. Lojë më e barabartë u zhvillua në periudhën e dytë. “Bardhekaltrit” kishin epërsi deri në 18 pikë gjatë pjesës së parë, derisa skuadrat shkuan në

pushim me rezultat 53:39. Në periodën e tretë mysafirët ishin më të mirë, duke ngushtuar shifrat në vetëm shtatë pikë, 62:57 dhe duke e bërë ndeshjen më interesante, derisa rezultati në semafor pas 30 minutash tregonte shifrat 71:62. Në 10 minutat e fundit Prishtina ngriti sërish epërsinë në 80:66, derisa triumfoi në fund me rezultat 93:83. Te Prishtina u dalluan Fahro Alihoxhiq dhe Jordan Johson me nga 20 pikë, kurse te Ylli më të dalluarit ishin Valon Bunjaku me

23 pikë, Vander Blue dhe Arbër Berisha nga 14 dhe Samir Zekiqi me 13. Në ndeshjen tjetër Bashkimi ka mundur në udhëtim Feronikelin me rezultat 66:82 (12:24, 18:20, 16:18, 20:20). Dayon Griffin ishte më i miri te skuadra nga Drenasi me 31 pikë, shtatë kërcime dhe shtatë asistime, kurse te skuadra prizrenase u dalluan Corey Ross me 21 pikë e pesë kërcime, Terik Bridgeman me 20 pikë e shtatë kërcime dhe Stevie Clark me 15 pikë e gjashtë kërcime.

Besa regjistron fitore bindëse në Ferizaj

FERIZAJ, 8 MARS - Besa Famgas ka fituar bindshëm ndaj Kastriotit në Ferizaj për ta përfunduar stinorin e rregullt me pikë maksimale (34:26). Tani gjashtë

skuadrat e para në tabelë garojnë për titull të kampionit në Superligën A, kurse katër të fundit garojnë për të mbetur në elitë, në Superligën B. Në Ferizaj,

Besa ka nisur shkëputjen në mes të pjesës së parë dhe ka arritur te fitorja bindëse. Kastrioti mbetet në vend të katërt me 22 pikë. Në dy ndeshjet e tjera

që u luajtën të shtunën nuk pati befasi. Vëllaznimi fitoi me një gol dallim ndaj Drenicës (31:30), ndërsa Llapi fitoi në Gjilan ndaj Dritës (30:49).



Zeneli: Më 26 mars Vokrrin dhe kombin do t'i bëjmë krenarë

Prishtinë, 8 mars - Ylli i Kosovës në futboll, Arbër Zeneli, përmes një postimi në “Instagram” ka paralajmëruar Maqedoninë e Veriut, para ndeshjes së “play-off” -it në Ligën e Kombeve. I rik-

thyer nga lëndimi, sulmuesi i Reimsit ka kujtuar legjendën Fadil Vokrri teksa ka thënë se më 26 mars do të luajnë që t'i bëjnë krenar Vokrrin dhe kombin shqiptar. “Ky gol ishte dedikuar

për një person të veçantë. Një person që e çoi futbollin tonë në një nivel tjetër. 26 marsi është dita ku ne mund të bëjmë histori dhe ta bëjmë atë dhe kombin tonë krenar! #sërishvjennmarsi”,

ka përshkruar Zeneli një fotografi gjatë festimeve për një gol, teksa në duar mbante fanelën me fotografinë e Vokrrit. Ndeshja Maqedoni e Veriut - Kosovë luhet më 26 mars në



Blazheviq: Në Kosovë kam kaluar periudhën më interesante

PRISHTINË, 8 MARS - Trajneri i njohur kroat, Miroslav “Çiro” Blazheviq, ka thënë se periudha e kaluar në Kosovë ishte më interesante në karrierën e tij shumë të gjatë. Blazheviq, 85-vjeçar, ka drejtuar Prishtinën në mesin e viteve tetëdhjeta, në edicionin kur mision ishte mbetja në elitën e futbollit të ish-Jugosllavisë. Misioni kishte përfunduar me sukses, ndërsa Blazheviq bëri shumë miq në Kosovë. Ai ende mbahet në mend si një prej trajnerëve më të mëdhenj që ka drejtuar Prishtinën në kohën e artë të saj. Blazheviq ka dhënë një intervistë të gjatë për sajtin në gjuhën serbe, “kosovo-online.com”, ku ka folur për periudhën të Prishtina. Ka thënë se me gjithë kohën e gjatë të kaluar prej kur ka punuar në Kosovë, kosovarët janë në zemrën e tij. “Vërtet ishte një aventurë, pasi karriera ime ka zgjatur shumë. Por kur më pyesin se cila periudhë ishte më e mira për mua, unë them se më interesanteja ishte në Kosovë. Vetë fillimi ishte i çuditshëm, pasi unë me Grasshoppersin kisha fituar titullin”, ka thënë Blazheviq në fillim të intervistës.

Legjenda kroate ka thënë se në vitin 1986 nuk e kishte fare në mendje Prishtinën. Ka treguar se e kanë takuar dy persona që i thanë se kanë dhënë besën që do ta sjellin në Prishtinë. “Unë e di çka është besa, por në fillim nuk i kam marrë seriozisht. Insistimi i tyre, se vetëm unë mund t’ju ndihmoj që mos të bien nga liga, ka sjellë disa dyshime në mendimet e mia. Në fund pranova dhe nuk jam penduar”, ka thënë Blazheviq. Sipas tij, bëhej fjalë për persona të klubit, por edhe të Komitetit të atëhershëm, që në atë periudhë ishin njerëzit kryesorë. Blazheviq e kujton me shumë dëshirë periudhën te



Prishtina. Ka bërë miq të mirë, ndërsa tani fëmijët e tyre i drejtohen me shumë dashuri. Kjo sipas legjendës është shenjë se ka lënë gjurmë. “Ne trajnerët varemi edhe nga rrethanat. Atëherë të gjithë ishin në këmbë dhe është jetuar për atë që Prishtina të shpëtojë. Unë kam ardhur si një lloj ylli, pasi kisha fituar titullin me Dinamon në vitin 1982. Pritjet ishin shumë të mëdha që do t’i shpëtojmë nga rënia prej ligës. Mund të mendoni tani, 35 mijë njerëz vazhdimisht ishin në stadium e po aq jashtë tij. Ishte një eufori e futbollit që nuk harrohet. Ne trajnerët gjithnjë e dëshirojmë një atmosferë të tillë, klimë të tillë. E çfarë klime kanë krijuar për mua miqtë e mi, është e paharruar”. Blazheviq ka thënë se të gjithë lojtarët e Prishtinës ishin të thjeshtë. Ka theksuar se as legjendën Fadil Vokrri nuk e ka lejuar që të veçohet. Sipas tij, është gabim i trajnerit kur ndonjë lojtar favorizohet. Ai ka konfirmuar se tifozët e kanë bartur në krah nga stadiumi deri në “Grand Hotel”. “Më kanë hedhur në ajër te ‘Grand Hotel’ aq sa të arrija në katin e dytë. Tereza Kesovija, të cilën e kam ftuar që të nisë topin nga mesi, ishte në dritare në katin e dytë, ndërsa tifozët më hidhnin mua. Kur e ka parë se si po fluturoj ka mbetur e shokuar.

Është një prej momenteve që i kam përjetuar në Kosovë. Në çdo vend atje kam ndier shumë dashuri. Ndërsa ne trajnerët varemi nga rezultatet. Kur i ke atëherë je njëshi, kur nuk i ke mbledh plaçkat dhe ik”. Sipas Çirës, ndeshja më e rëndësishme ishte me Vardarin, ndoshta vendimtare. Ka thënë se në atë ndeshje ka bërë diçka që nuk e ka bërë asnjëherë tjetër në karrierë. Ka kërcënuar lojtarin më të mirë të kundërshtarit. Ka folur për raporte me njerëz të politikës të asaj kohe dhe rrezikun që ishte ta drejtonte Prishtinën. Ka treguar se vazhdimisht ka pasur roje me vete që ia ka siguruar Prishtina. “Natyrisht se ishte rrezik. Ku shkoj unë është rrezik”. Blazheviq ka përjashtuar mundësinë që të ketë pasur ndeshje të kurditura në atë kohë. Me lojtarët që i kishte te Prishtina nuk ka kontakt, por vazhdimisht takon dikë nga Kosova dhe bën fotografi. “Nuk kam qenë kohë të gjatë në Prishtinë, por kam dëshirë që të vijë si anonim dhe pak të kujtoj atë kohë”, ka thënë Blazheviq. Ai ka thënë se mori Prishtinën në vend të fundit dhe kampionatin e mbylli në mes të tabelës. I është kthyer edhe një herë pritjes në Prishtinë. “Nuk arritur në tre të mëngjesit dhe mijëra njerëz më kanë pritur. Të gjithë kanë besuar se me ardhjen time Prishtina do të shpëtojë. Nuk ishte lehtë të përballohej ai presion. Kur pritjet janë të mëdha për shkak të renomesë dhe kredibilitetit, atëherë duhet të përgatitesh mirë për t’i arsyetuar pritjet. Nuk ishte fitore e futbollit. Ishte fitore nacionale, ashtu e kanë pranuar ata”, ka thënë Blazheviq. Sipas tij, Kosova ka lojtarë të talentuar dhe se përfaqësuesja e Kosovës ka dëshmuar se mund të jetë konkurrente.

Housonit nuk i mjafton Hardeni, Denveri befasohet nga Clevelandi

Charlotte, 8mars - Janë zhvilluar gjashtë ndeshje në NBA në një mbrëmje ku nuk munguan surprizat. Befasinë më të madhe e bëri Charlotte Hornetsi, që mposhti me 19 pikë diferencë, 108-89, Houson Rocketsin. Një ndeshje që u kushtëzua nga starti i pabesueshëm i vendasve, që morëm që në fillim avantazhin 20-0. Përcaktues Terry Rozier me 24 pikë, pa harruar edhe mbështetjen e madhe me 23 pikë të Devonte’ Graham. Nuk mjaftuan për Rocketsin “triple-double” i James Hardenit, 30 pikë, 14 asistime e 10 “rebounde” dhe 25 pikët e Robert Covingtonit. Humbje e papritur edhe për Denver Nuggetsin, 104-102, në parketin e Cleveland Cavaliersit, që mbyllin klasifikimin në Konferencën e Lindjes. Skuadra nga Colorado me këtë disfatë humbet kontaktet me Los

Angeles Clippersin në garën për vendin e dytë në Perëndim. Spikatin në suksesin e Cavs Kevin Love me 27 pikë dhe Collin Sexton me 27, ndërsa Nuggetsi paguan paraqitjen nën

REZULTATET		
Charlotte Hornets - Houston Rockets		108-99
Detroit Pistons - Utah Jazz		105-111
Cleveland Cavaliers - Denver Nuggets		104-102
Memphis Grizzlies - Atlanta Hawks		118-101
Golden State Warriors - Philadelphia 76ers		118-114
Portland Trail Blazers - Sacramento Kings		111-123

mesatare të Nikola Jokiqit, që e mbylli ndeshjen me vetëm 8 pikë. Viojnë problemet në transfertë për Philadelphia 76ers, që këtë radhë u dorëzua në parketin e Golden State Warriorsit, i cili nuk kishte në përbërje Stephen Curry. U mbyll 118-114 në “Chase Center” të San Franciscos, me

vendësit që përmbysin shifra në periodën e fundit falë një rezultati të pjesshëm 36-24. Vendimtarë në fitoren e Warriorsit Damion Lee dhe Eric Paschall, respektivisht me 24 dhe 23 pikë, ndërsa te Philadelphia më i miri rezultoi Tobias Harris me 24 pikë, raporton “Superport”. Respektoi parashikimet Utah Jazz, që iu imponua 105-111 Detroit Pistonsit. Përcaktuese pjesa e parë që u mbyll 55-39 në favor të miqve, në radhët e të cilëve spikati Bogdan Bogdanovic me 32 pikë. Për “Pistons” nuk mjaftoi “double-double” i Christian Woodit (30 pikë dhe 11 “rebounde”). Fitore e rëndësishme për Memphis Grizzliesin, që kaloi 118-101, me 27 pikë dhe 17 “rebounde” të Valanciunas, Atlanta Hawks, duke konsoliduar pozicionin e tyre në zonën “play-off” në Konferencën e Perëndimit.

SHKURT

Boban: Nuk e dija se ishim në Korenë e Veriut

Zvonimir Boban u largua zyrtarisht nga bordi drejtues i Milanit. Pas shkarkimit nga bordi drejtues, kroati ka reaguar për herë të parë, duke thënë se marrëveshja me trajnerin e ardhshëm është mbyllur që në dhjetor. “Nuk e dija se ishim në Korenë e Veriut. Intervista ime për ‘La Gazzetta dello sport’ është e përsosur juridikisht. Ajo erdhi pas kaq shumë kërkesave për sqarim që u inoruan me përpikëri. Marrëveshja me Rangnik u mbyll në dhjetor. I uroj Rangnik më të mirat e mundshme, por ata duhej të ma thoshin, duhet të isha informuar”, ka thënë Boban, i cili zbulon edhe një prapaskenë për merkaton e janarit. “Ne nuk mund të bënim disa zgjedhje pa pëlqimin e trajnerit të ri”, ka deklaruar Boban.

Boca Juniorsi fiton titullin në javën e fundit

Boca Juniorsi ka fituar titullin kampion në Argjentinë në javën e fundit. River Plate ishte në kryesim, por barazimi në javën e fundit kundër Atletico Tukumanit ishte vendimtar. Boca fitoi ndeshjen në shtëpi ndaj Gimnasia La Plata të Diego Armando Maradonës me rezultatin 1-0. Një fitore minimale, por që i dha titullin kampi-on. Hero i vendësve ishte kapiteni Carlos Tevez me golin e shënuar në minutën e 72-të.

Arsenali do ta rikthejë Mkhitaryanin

Mesfushori Henrikh Mkhitaryan te Roma nuk është aspak i sigurt. I huazuar për një sezon nga Arsenali, fantazisti armen pritet të rikthehet te “Topçinjtë” jo vetëm për çështje kontraktuale, ku nuk parashikohet e drejta e blerjes nga Roma, por edhe për dëshirën e trajnerit Mikel Arteta. Ky i fundit u shpreh hapur se i pëlqen të ketë në skuadër një lojtar si Mkhitaryan, të cilin e njeh mirë dhe që, sipas tij, përshtatet me çdo stil loje. 31-vjeçari ka edhe një vit kontratë me Arsenalin dhe nëse rikthehet për të qëndruar te “Topçinjtë”, nuk përjashtohet as rinovimi i kontratës.

City mendon ta shesë Agueron

Manchester City është duke u përgatitur ta shesë sulmuesin Sergio Aguero në verë. Sipas medi-umit britanik “The Sun”, City do ta lejojë Agueron të largohet nëse konfirmohet dënimi i tyre dy-vjeçar në Ligën e Kampionëve nga UEFA. City është i bindur se do ta mbajë pjesën më të madhe të skuadrës së tyre, pavarësisht se është dënuar nga garat evropiane për dy vjet. Klubi është duke e luftuar në Gjykatën e Arbitrazhit për Sport pasi u shpall fajtor nga UEFA për shkeljen e rregullave të “Fari Play Financiarit”. Por, nëse apeli i tyre është i pasuksesshëm, City do të jetë i gatshëm ta lejojë Agueron të largohet në kërkim të futbollit të rregullt në Ligën e Kampionëve. Pas këtij sezoni, Aguero do të hyjë në vitin e fundit të kontratës së tij në “Etihad” dhe ai do të trajtohet si një rast i veçantë, megjithëse nuk ka ndonjë sugjerim që 31-vjeçari argjentinasi dëshiron të largohet nga City. Për Agueron thuhet se interesim kanë shprehur dy klubet spanjolle, Real Madridi dhe Atletico Madridi.

Autor : Gazmend Morina - BENI	KËNGËTARJA NË FOTO 1	DEGË E MJEKËSISË	GJENDJE E MËRZITSHME	GURRA	ZAMBIA, ANGOLA	GRIMCA MË E IMËT E ÇDO ELEMENTI KIMIK	KËNGËTARJA AMERIKANE XHONS	ASI, KAM- PIONI (Sport)	EPOKA ERE	ZANORE	NJËSI PESHE PËR GURËT E ÇMUAR (shq.)	BOTIMET	1 				
MUAJ I SHEN- JTË I MYSLI- MANËVE									U ARRATISE HAPEËSIRË QIELLORE (Poet.)								
FJALË TIN- GULLIMIT- UESE										ADEM DEMAÇI KRYEQYTETI I KANADASË							
BARI I THARË					ARTI I TË FOLURIT (pashq.) EMËR MASH- KULLI MYSLI- MAN												
FUTBOLLISTI SAMUEL ... (Inter)				BISKOTË E GATUAR ME ARRA (sh.shq.) BENDI MUZI- KOR ".... MAIDEN"													
VAJTIMI ME LOT							PASURIA E PATUNDSHME QË SILLTE TË ARDHURA INTERESI BAN- KAR NGA KRE- DIA										
PERËNDESHA E DASHURISË ROMAKE (mit.)						BASHKËTING- ËLLORE		KËNGËTARJA & AKTORJA E VJETËR MORENO	VENEZIA INSTITUTE MANAGEMENT NUMËR THE- MELOR				VENDEË, RRËNJËS	↓	BANORËT E NJË QYTETI TONË ISMET MUNISHI	VLERËSIMI I NXËNËSIT NGA MËSUESI	LUMË NË AUS- TRI
QË KA TË BËJË ME GJI- NINË						AKTORJA DOBROSHI EMËR MASH- KULLI ITALIAN					ZANORE "A" në mes të dy "S"						
ZANORE		INDIUM XEHETAR			FUTBOLLISTI SHQIPTAR BAJRAMI ZANORE					DIKTATOR SOVJETIK (shq.) KLUB FUT- BOLLI NOR- VEGJEZ							
SHKRONJA XVI & XVIII			ZYRË NDIHME JURIDIKE	MALLKIMI KISHTAR BABAI								KËNGËTARI MUSHKOLAJ JARAN, SHOK					
FOLTORJA					AKTORJA ... RINA DRAMË E SANTORIT				TURK I VJET- ËR VEPRA LETRA- RE						TITAN PJATA (krah.)		
BODRUMI I PIJEVE								DY BASHKË- TINGËLLORE KËNGËTARJA NË FOTO 2			CILI ME RADHË IRIDIUM, AMPER						SIMBOL I FESË MYSLIMANE, BESIM (shq.)
GATESË						NOTË MUZIKO- RE	TENISTI I NJOHUR ENDI (shqip.)						FNJËRI NGA VËLLEZËRIT FRASHËRI STADIUMI MË I MADH NË BRAZIL				
VEGËL MUZI- KORE				INVA MULA KYÇ			PATRIOTI PRIZRENI					VËNIE E MINA- VE NYNBERG, AUGSBURG					
EPOKA ERE	KOHA E ÇAK- TUAR PËR PUNË BASHKËTING- ËLLORE						VEND I ÇEKËT NË NJË LUMË XHELAL (shk.)			RROGA VJET- ORE E PAPËS PËREMËR PRONOR						ZANORE E QESHUR TALLËSE	
DERË E VOGËL E THURUR ME THUPRA A ME DEGË (shq.)						ISH DISENJA- TORI VER- SAÇI AKTORI DESTANI (shq.)					ABEDIN REXHA INTERNATIONAL PHONETIC ALPHABET			RINOR (perkdh.) BUFE, KAFE- NE (bised.)			
2 					KUNDREJT MALLKIMI							AI QË E KISH- TE DOBËSI THEMBRËN INATOSJE					
					LOUISIANA LIBRARY ASSOCIATION			GJINI E KRI- JIMTARISË LETRARE FJALË POHUESE					ZANORE AKTORI EGJIP- TIAN SHARIF			ENDE	
					ZANORE	JOD, FOS- FOR BIMË ME TË CILËN BËJMË PILAF			FIGURË STILI- STIKE DY BASHKË- TINGËLLORE								
					PJESË E MOTORIT					I PA GJAK SUPER MODELJA ... HERZIGOVA							
					ARMATA REPUBLIKANE IRLANDEZE (shk. org.)			AKTORJA HOL- LIVUDIANE CATHERINE JONES ZANORE					PËREMËR VETOR DY BASHKË- TINGËLLORE				
					INSEKT I MËR- ZITSHËM				VINCENZA, INTER BASHKËTING- ËLLORE			YNDYR PËR FYTYRË AUSTRIA					
					KUNDREJT I BARDHË			KAPILAR I GJAKUT							TONI ANDER- SON		



Lume's Details
Estetik & Depilim

Fatlume Shabani

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

Salloni i Depilimit 'Lume's Details' në Prishtinë kërkon një praktikante e cila pastaj mund të punësohet me pagesë nëse tregon rezultat të mirë gjatë kohës së praktikës.

Të interesuarat mund të paraqiten në këta numra kontaktues: 045681898 dhe 044900978


RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

facebook www.facebook.com/gjejpuneshpejte

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► "Nitro" SH.P.K. shpall të humbur certifikatën e TVSH-së, me nr. 810091950

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkudjesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesë me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesë me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesë me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Lëshoj banesë me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

► Lëshoj banesë e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049/44-888-801 (viber)

► Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

► Lëshoj banesë një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

► Lëshoj me qira banesë e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.

► Kërkojmë 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, kati i I-rë, ka 3 dhoma, banjo, ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet. Për info: 045/699-221.

► Lëshohet me qira banesa në lagjen Bregu i Diellit te furra Qërimi 2. Banesa është në katin e tretë, ka sallon dhe kuzhinë si dhe dy dhoma të fjetjes. Numri i telefonit: 044 332 640.

► Lëshohet banesa me qira në Prishtinë në lagjen "Ulpiana", afër AAK-së. Për informata lajmërohuni në tel: 044/162-783

► Lëshoj banesë me qira në Ulpianë, tek Fontana në: E 30-3A, nr.27, kati -IV-. Çmimi sipas marrëveshjes në info: 044-132-368.

Shes truallin prej 36 arë në fshatin Besi; 150 metra nga magjistrallja Prishtinë-Besianë. Trualli ka gjithë infrastrukturën e nevojshme dhe është shumë i përshtatshëm dhe për banim kolektiv. Po ashtu lëshojmë me qira vendin për restorant me një pamje atraktive dhe piktoreske me në një lartësi të madhe mbidetare.

Tel. 044-413-197.

AUTOSHKOLLA RITMI

044 248 173
045 626 123
044 648 122

PRISHTINË

autoshkollaritmi@gmail.com



Në prag të 5, 6, 7 dhe 8 Marsit ditëve të lavdisë dhe sakrificës së familjes Jasharaj, ditës së mësuesit dhe ditës së nënës, për kandidat/etë interesuar për regjistrim të marrjes së patentë shoferit ofroj lehtësim financiar. **Vijimi i orëve praktike dhe teorike për 20 ore nga 200.00 Euro në 150.00 Euro.**

Interesimi i juaj - përkushtimi ynë. Eksperienca jonë - suksesi i juaj. Afati i paraqitjes prej 02.03. 2020 deri më 20.03.2020

